

Agim
VINCA



FLET PËR "EPOKËN E RE", SELIM PACOLLI | FAQE 4-5

Ligji për Prishtinën sjell etapë të re zhvillimore për kryeqytetin

Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ka mirëpritur miratimin e Ligjit për Prishtinën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se ky ligj do ta sjellë fillimin e një etape të re zhvillimore për

kryeqytetin. Ai ka thënë se ligji barazon trajtimin e Prishtinës me secilën kryeqendër të shteteve të rajonit dhe më gjerë. Krahas pozitës së veçantë që i garantohet kryeqytetit, sipas Pacollit, përfitim që sjell ligji është edhe rritja e

buxhetit të komunës nga grantet e Qeverisë. Ai ka treguar se kjo nënkupton rritje të mundësive për investime të reja në kryeqytet, duke shtyrë përpara një varg projektesh që, shkak i implikimit buxhetor, janë shtyrë nga viti në vit

Opozita: Pafuqia e koalicionit qeverisës do ta vonojë liberalizimin e vizave

Procesi i integritimit evropian dhe liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës ka qenë tema që ka përplasur të hënën pozitën dhe opozitën. Përderisa kryeministri Ramush

Haradinaj ka shprehur optimizëm se i gjithë procesi i liberalizimit të vizave do të përmbyllet deri në fund të këtij viti, shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës

(LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se pafuqia e koalicionit qeverisës për t'i ndërmarrë reformat e nevojshme do ta vonojë liberalizimin e vizave dhe integrimin evropian të Kosovës



AKTUALE

POLITIKA ËSHTË GJITHMONË EDHE 'LUFTË'

F. 11
NGA MIMOZA
KELMENDI



KMDLNJ-ja, THAÇIT: MOS E DEKRETONI GJYQOTARIN RADOMIR LABAN F. 6

PROJEKTKODI PENAL I KOSOVËS U SHKON PËR VOTIM DEPUTETËVE F. 6

EKONOMI

HARADINAJ KËRKON TË JETËSOHET SA MË PARË ZONA EKONOMIKE AMERIKANE F. 9

USAID-i, PARTNER ME ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT PËR ZBULIMIN E MASHTRIMIT F. 8

KULTURË

KATËR DITË PËR PAFUNDËSINË F. 15

Besim ZYMBERI

SPORT

KLUBET NË AKSION TË PËRFORCIMEVE F. 14

MAJLINDA KELMENDI PAJISËT ME PASAPORTË DIPLOMATIKE F. 14



Kurti kërkon dialog me Serbinë pa përfshirjen e Thaçit dhe Tahirit

Në asnjë rrethanë presidenti Hashim Thaçi dhe ish-ministrja Edita Tahiri nuk duhet ta udhëheqin apo ta përfaqësojnë Kosovën në dialogun me Serbinë. Kështu ka thënë të

hënën lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë me gazetarë, në të cilën ka prezantuar propozimin e kësaj lëvizje "Plani 4+1" për procesin e dialogut

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kukan: Pa Ballkanin Perëndimor, Bashkimi Evropian nuk është i plotë

BEOGRAD, 21 MAJ - Eurodeputeti Eduard Kukan thotë se Bashkimi Evropian nuk është i plotë pa Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, paralajmëron vendet e rajonit, se Franca, Gjermania dhe Holanda kanë qenë gjithmonë shumë të rrepta në lidhje me pranimin e anëtarëve të rinj. Eurodeputeti Eduard Kukan për mediet serbe ka folur gjerësisht për Ballkanin Perëndimor dhe për

aspiratat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ai nënvizon se edhe Brukseli duhet ta luajë rolin e vet në këtë proces. "Pa një rajon të rëndësishëm siç është Ballkani Perëndimor, BE-ja nuk është e plotë dhe as e bashkuar. Duhet të jemi më të përgjegjshëm ndaj miqve tanë në Ballkanin Perëndimor. Nëse nga vendet kandidatë kërkojmë të plotësohen kërkesa të caktuara, atëherë

edhe ne duhet t'i mbajmë premtimet tona", është shprehur Kukan.

Eurodeputeti bën me dije se nuk pajtohet me deklaratat e presidentit të Francës, se nuk është koha për zgjerimin e BE-së deri në momentin që BE-ja të reformohet në themel. "Qëndrimi i Macronit është vetëm një nga pikëpamjet në bisedimet për të ardhmen e BE-së. Kjo është një nga idetë e tij

me të cilën unë thëllësisht nuk pajtohem dhe jam kundër qëndrimeve të tij", nënvizoi Kukan. Ndërsa paralajmëron në mënyrë indirekte Shqipërinë dhe Maqedoninë duke thënë se "Franca, Gjermania apo Holanda kanë qenë gjithmonë shumë të rrepta në lidhje me pranimin e anëtarëve të rinj dhe kjo nuk ndryshon". Sa i përket vitit 2025, Kukan shprehet se së pari duhet të



zbatohen reformat, më pas të shikohet çështja e anëtarësimit.

Ministrja Hoxha: Të zbatohen me prioritet reformat në kuadër të MSA-së

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, duke prezantuar gjendjen për zbatimin e MSA-së, ka ftuar kabinetin qeveritar të punohet maksimalisht që reformat kyçe të planifikuara që nuk kanë arritur të zbatohen, të trajtohen me prioritet

"Epoka e re"

PRISHTINË, 21 MAJ - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, në mbledhjen e Qeverisë mbajtur të hënën, ka paraqitur gjendjen e reformave kyçe të planifikuara që nuk kanë arritur të zbatohen në kuadër të MSA-së.

Ministrja Hoxha ka prezantuar gjendjen rreth zbatimit të Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së gjatë vitit të kaluar, bazuar në të gjeturat e raportit vjetor, të hartuar nga Ministria e Integritimit në bashkëpunim me të gjitha institucionet përgjegjëse. "Për vitin 2017 ky program ka paraparë zbatimin e 967 masave afatshkurta, prej të cilave 260 ose rreth 26 % e tyre kanë qenë masa legislative, ndërsa pjesa

tjetër prej 707 masave ose rreth 74 % e tyre kanë qenë masa zbatuese", ka theksuar ministrja Hoxha, duke shtuar se shkalla e përgjithshme e zbatimit të programit është 62.05 %, pasi që 600 nga 967 masat e planifikuara janë zbatuar, ndërsa pjesa e mbetur prej 367 masave, ose 37.95 % nuk kanë arritur të zbatohen.

Më tej, Hoxha ka theksuar se sa iu përket reformave legislative, të gjeturat tregojnë se është arritur një shkallë zbatimi prej 38.47 %, pasi që janë arritur të zbatohen 100 nga 260 masa afatshkurtra legislative të planifikuara, ndërsa 160 prej tyre, ose 61.53 % nuk kanë arritur të zbatohen. "Programi ka paraparë zbatimin e 707 masave zbatuese, ndërsa në këtë nivel është arritur një shkallë zbatimi prej 70.72 %,



pasi që është arritur të zbatohen 500 nga 707 masat afatshkurtra të planifikuara, ndërsa 207 prej tyre, ose 29.28 %, nuk kanë arritur të zbatohen", ka

theksuar ministrja Hoxha. Sipas të gjeturave të këtij raporti vjetor, ka vënë në pah ministrja Hoxha, reformat kyçe të planifikuara që nuk kanë arritur të

zbatohen duhet të jenë prioritet. Ajo ka ftuar kabinetin qeveritar të punohet maksimalisht që të gjitha këto çështje të trajtohen me prioritet.

Kosova, element kyç për anëtarësimin e Serbisë në union

BEOGRAD, 21 MAJ - Kosova është element kyç për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian, deklaroi shefi i delegacionit të BE-së në Beograd, Sem Fabrizi. "Normalizimi i marrëdhënieve

me Prishtinën dhe progresi në fushën e demokracisë dhe shtetit të së drejtës janë dy forcat tërheqëse që do ta ndihmojnë Serbinë për t'u anëtarësuar në BE", theksoi Fabrizi.

"Natyrish, Kosova është elementi kyç dhe Bashkimi Evropian ka vëzhguar gjithë rëndësinë e këtij procesi duke ofruar shërbimin në bisedimet në mes të Prishtinës dhe

Beogradit", tha Fabrizi. Ndërsa pyetjes se nëse Serbia duhet ta njohë Kosovën për të hyrë në BE, diplomati theksoi se "BE-ja ka statusin e neutralitetit dhe që të kërkohet është diçka

normale në marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Prishtinës". "Nëpërmjet dialogut Bashkimi Evropian ofron shërbimet për ta arritur këtë objektiv", tha Fabrizi.

Vuçiqi: Kisha nuk duhet të merret me Kosovën

BEOGRAD, 21 MAJ - Kryetari i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka mohuar vlerësimet se shteti po silltet sikur Kisha Ortodokse Serbe është fajtorë për çështjen e Kosovës. "Nuk mendoj se vendimet më të rëndësishme

politike duhet t'i marrë Kisha Ortodokse Serbe", deklaroi Vuçiq. Ai shtoi se "Kisha nuk ka nevojë të merret me vendimet politike, që përcaktojnë kahun e vendit, por që, natyrish, mund të japë mendime e këshilla",

deklaroi Aleksandar Vuçiq. Duke komentuar nëse shteti ka akuzuar Kishën si fajtorë për çështjen e Kosovës, Vuçiqi tha se "Kisha Ortodokse Serbe për asgjë nuk është fajtorë". "Ne jemi shtet sekular dhe respektojmë Kishën.

Jam besimtar, ndonëse jo i devotshëm, por mendoj se, si përfaqësues i shtetit, kam kontribuar diçka në të mirë të Kishës, mbase nuk mund të gjendet një tjetër që ka bërë më shumë për Kishën Serbe", tha Vuçiqi.



Opozita: Pafuqia e koalicionit qeverisës do ta vonojë liberalizimin e vizave

Procesi i integritit evropian dhe liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës ka qenë tema që ka përplasur të hënën pozitën dhe opozitën. Përderisa kryeministri Ramush Haradinaj ka shprehur optimizëm se i gjithë procesi i liberalizimit të vizave do të përmbyllet deri në fund të këtij viti, shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se pafuqia e koalicionit qeverisës për t'i ndërmarrë reformat e nevojshme do ta vonojë liberalizimin e vizave dhe integritin evropian të Kosovës

asnjëherë nuk do të ndalet, por nuk duhet të bëjmë gabime dhe duhet ta përçojmë porosinë se qytetarët e vendit e meritojnë lëvizjen e lirë. Ne prej Kosovës nuk do t'u dërgojmë vendeve të BE-së krim e emigrantë, por shkëmbime", është shprehur Haradinaj.

Ndërsa shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se pafuqia e koalicionit qeverisës për t'i ndërmarrë reformat e nevojshme do ta vonojë liberalizimin e vizave dhe integritin evropian të Kosovës. "Samiti i Sofjes ka rikonfirmuar qëndrimin e Bashkimit Evropian (BE) për perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Promovimi i demokracisë, drejtësisë efikase, rendit dhe ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, fqinjësia e mirë, menaxhimi i migracionit dhe çështje të tjera, mbesin sfida për Kosovën, në veçanti duke pasur parasysh brishtësinë e Qeverisë për shkak të mungesës së shumicës parlamentare për t'i ndërmarrë këto reforma. Nuk ka dyshim se pafuqia e koalicionit të pakicës

për t'i ndërmarrë këto reforma do ta vonojë integritin evropian të Kosovës dhe, para së gjithash, liberalizimin e vizave. I gjendur në një situatë të tillë, z. Haradinaj fajëson LDK-në se po pengon liberalizimin e vizave. Sikur z. Haradinaj të mos përdorte dhunë të shfrenuar ndaj institucioneve gjatë mandatit të kaluar, sot qytetarët e Kosovës do të udhëtonin të lirë. Ai duhet ta ketë dinjitetin ta pranojë këtë fakt", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Sipas tij, me këtë Qeveri demokracia dhe sistemi ynë parlamentar janë në rrezik. Në këtë kontekst, Hoti ka thënë se kryeministri nuk i përgjigjet Kuvendit, ai dhe ministrat e tij nuk marrin pjesë në seanca dhe komisione parlamentare. Ai ka theksuar se vendimet e Qeverisë në plot raste janë arbitrare dhe në kundërshtim me ligjin. Po sipas Hotit, kryeministri ndërhyrë drejtpërdrejt në vendimmarrje të organeve të pavarura. "Çfarë sinjali dërgojmë në Bruksel kur katër ministra me aktakuza të ngritura vazhdojnë të shërbejnë në Qeveri? Si mund të merret seriozisht kjo Qeveri nga Brukseli dhe nga qytetarët e Kosovës kur

dokumenti kryesor për integritin evropian për tre vjetët e ardhshëm, Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së për 2018-2020, u diskutua në Kuvendin e Kosovës të premten e javës që shkoi, në mungesë të plotë të kabinetit qeveritar. Si mund të na besojë BE-ja se kemi një demokraci funksionale, sado të brishtë, kur pa asnjë procedurë ligjore i dëbojmë shtetasit turq, ose pa pritur ndërmarrim iniciative ligjore për t'iu ikur obligimeve ndërkombëtare? Si mund të na besojmë në Bruksel në rendin demokratik e parlamentar, kur vetë deputetët shkelin ligjin dhe ndërmarrim nismë ligjore për të siguruar amnisti për veten?", ka deklaruar Hoti.

Por ndaj deklaratës së Hotit ka reaguar deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Teuta Haxhiu. Ajo ka ironizuar me Hotin duke thënë se ai flet, por nuk ia qëllon kurrë. Sipas saj, liberalizimi i vizave do të ndodhë në afatin edhe më të shpejtë. "Tani jemi edhe më të sigurt se do të ndodhë liberalizimi i vizave në afatin edhe më të shpejtë ngaqë ka folur Avdullah Hoti, i cili flet, po kurrë nuk ia qëllon!", ka shkruar deputetja Haxhiu në llogarinë e vet në "Facebook".

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shprehur optimizëm të hënën se Bashkimi Evropian (BE) do ta miratojë liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Ai ka thënë se dinamika e paraparë në BE, por edhe në vendet veç e veç, mundëson që i gjithë procesi të përmbyllet deri në fund të këtij viti. "Në qershor institucionet e Bashkimit Evropian do të bëjnë vlerësimin, i cili besoj se është pozitiv. Ky vlerësim do të kalojë nëpër institucionet e BE-së, kurse ne do ta vazhdojmë dinamikën, punën me këto

institucione, sepse nevojitet aprovimi i vendeve veç e veç. Pra, si dinamikë kohore kjo çështje mund të përmbyllet deri në fund të këtij viti. Kjo dinamikë jep shpresa se qytetarët e Kosovës nga fundi i këtij viti të lëvizin lirshëm, pa viza drejt vendeve të BE-së", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë për medie.

Ai ka thënë se pas liberalizimit të vizave Kosova nuk do t'u dërgojë vendeve të BE-së krim e emigrantë, por shkëmbime. "Është me rëndësi që këtë porosi ta çojmë të gjithë prej Kosovës me kujdesin më të madh. Jeta e brendshme politike, gara e brendshme politike,



Haradinaj takon Metën, flasin për proceset në Kosovë dhe Shqipëri

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, është takuar të hënën me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta, me të cilin ka biseduar për çështjen e liberalizimit të vizave për vendin tonë dhe hapjen e negociatave për anëtarësimin e

shtetit shqiptar në Bashkim Evropian (BE). "Sot u takova me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta, me të cilin bashkëbiseduam për proceset aktuale në të cilën po kalojnë të dyja vendet. Liberalizimi i vizave për Kosovën dhe hapja e negociatave për BE

e Shqipërisë janë hapa të mëdhenj për ne, por edhe për rajonin në përgjithësi. Në këto dy çështje, por edhe për procese të tjera, bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri do të vazhdojë të fuqizohet", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Selim Pacolli

Ligji për Prishtinën sjell etapë të re zhvillimore

Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ka mirëpritur miratimin e Ligjit për Prishtinën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se ky ligj do ta sjellë fillimin e një etape të re zhvillimore për kryeqytetin. Ai ka thënë se ligji barazon trajtimin e Prishtinës me secilën kryeqendër të shteteve të rajonit dhe më gjerë. Krahas pozitës së veçantë që i garantohet kryeqytetit, sipas Pacollit, përfitim që sjell ligji është edhe rritja e buxhetit të komunës nga grantet e Qeverisë. Ai ka treguar se kjo nënkupton rritje të mundësive për investime të reja në kryeqytet, duke shtyrë përpara një varg projektesh që, shkak i implikimit buxhetor, janë shtyrë nga viti në vit

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 21 MAJ - Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, e ka vlerësuar hap të jashtëzakonshëm miratimin e Ligjit për kryeqytetin nga Kuvendi i Kosovës. Ai ka treguar se ky ligj ia ofron kryeqytetit vendin që meriton si lokaliteti me gravitimin më të madh në Republikën e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Pacolli është shprehur i bindur se miratimi i ligjit nënkupton fillimin e një etape të re zhvillimore për Prishtinën. "Ky ligj barazon trajtimin e Prishtinës me secilën kryeqendër të shteteve të rajonit e më gjerë që, për shkak të specifikave, pashmangshëm trajtohen më ndryshe. E them me plot bindje se drita e gjelbër në Kuvendin e Kosovës për këtë nismë nënkupton nisjen e një etape të re zhvillimore për Prishtinën", ka thënë Pacolli.

Ai ka treguar për të mirat që do t'i sjellë kryeqytetit ky ligj, duke shtuar se tani mundësitë e investimeve në Prishtinë do të jenë më të mëdha. "Krahas pozitës së veçantë që i garantohet kryeqytetit, përfitim do të ketë edhe në rritjen e buxhetit të komunës nga grantet e Qeverisë. Kjo nënkupton rritje të mundësive për investime të reja në kryeqytet, duke shtyrë përpara një varg projektesh që, shkak i implikimit buxhetor, janë shtyrë nga viti në vit", ka thënë Pacolli, duke përmendur edhe policinë dhe spitalin e kryeqytetit që ia mundëson Prishtinës ky ligj. "Një indikator pozitiv është edhe krijimi i Policisë së kryeqytetit që, me

stafin e dedikuar enkas për Prishtinën, do të jetë efikase për menaxhimin e sfidave, që prej atyre në trafik e më gjerë, në bazë të kompetencave. Me këtë ligj Prishtinës i garantohet edhe spitali. Një gjë tjetër që vlen për t'u përmendur është mundësia e krijimit të ndërmarrjeve publike nga komuna, duke mos iu nënshtruar procedurave me nivelin qendror që nga përvoja janë dëshmuar problematike në të kaluarën", është shprehur Pacolli.

Nënkryetari i Komunës së Prishtinës ka bërë me dije se ligji ka mundur të bëhet shumë më herët por, sipas tij, kjo nuk ka ndodhur për shkak të rivalitetit politik që ka ekzistuar

mes pushtetit qendror dhe atij lokal. "Fatkeqësisht, ky ligj, siç e ceka edhe më parë, do të duhej të kalonte shumë kohë më herët. Kanë qenë rivalitetet politike mes nivelit qendror dhe lokal ato që kanë sjellë në gjendjen ku jemi tash. Ta kalojmë ligjin pas një dekade shtet. Miratimi i Ligjit për Prishtinën në këndvështrimin tim ka qenë sukses edhe në këtë rrafsh sepse është dëshmuar pjekuri politike dhe vënie e interesave të qytetarit në rend të parë. Unë shpresoj shumë se ky do të jetë vetëm shembulli i parë i së ardhmes ku vendimmarrësit, pa dallime politike, do të vepronë pa inate, në të mirën e qytetarëve", ka thënë Pacolli.

Në këtë intervistë Selim Pacolli ka folur edhe për qeverisjen në komunë, duke thënë se puna e kësaj Qeverie do ta prekë secilin qytetar të Prishtinës.

"Epoka e re": Z. Pacolli, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Prishtinën. Çfarë do të thotë kjo për kryeqytetin?

Pacolli: Miratimi i Ligjit për Prishtinën përbën një hap të jashtëzakonshëm e që do të duhej të ndërmerrej kohë më parë. Ky ligj ia ofron kryeqytetit vendin që e meriton si lokaliteti më i madh e me gravitimin më të madh në Republikë. Ky ligj barazon trajtimin e Prishtinës me secilën kryeqendër të shteteve të rajonit e më gjerë që,

për shkak të specifikave, pashmangshëm trajtohen më ndryshe. E them me plot bindje se drita e gjelbër në Kuvendin e Kosovës për këtë nismë nënkupton nisjen e një etape të re zhvillimore për Prishtinën.

"Epoka e re": Cilat do të jenë përfitimet kryesore të Prishtinës nga ky ligj?

Pacolli: Krahas pozitës së veçantë që i garantohet kryeqytetit, përfitim do të rritet buxheti i komunës nga grantet e Qeverisë. Kjo nënkupton rritje të mundësive për investime të reja në kryeqytet, duke shtyrë përpara një varg projektesh që, shkak i implikimit buxhetor, janë shtyrë nga viti në vit. Një



re për kryeqytetin

qeveritë e deritashme e kanë vonuar kaq shumë këtë ligj?

Pacoli: Ky ligj, siç e ceka edhe më parë, do të duhej të kalonte shumë kohë më herët. Kanë qenë rivalitetet politike mes nivelit qendror dhe lokal ato që kanë sjellë në gjendjen ku jemi tash, ta kalojmë ligjin pas një dekade shtet. Miratimi i ligjit për Prishtinën, në këndvështrimin tim, ka qenë sukses edhe në këtë rrafsh sepse është dëshmuar pjekuri politike dhe vënie e interesave të qytetarit në rend të parë. Unë shpresoj shumë se ky do të jetë vetëm shembulli i parë i së ardhmes ku vendimmarrësit, pa dallime politike, do të veprojnë pa inate, në të mirën e qytetarëve.

"Epoka e re": Sa jeni të kënaqur me qeverisjen e kryetarit Ahmeti?

Pacoli: Mandati i parë i kryetarit Ahmeti ka qenë i përqendruar kryesisht në vënien në binarë të shumë sfidave me të cilat është ballafaquar Prishtina. Tashmë kur kjo fazë është përfunduar me sukses, u hapet rrugë investimeve edhe më të mëdha të cilat do të ndihen nga qytetarët në secilin cep të qytetit. Është ende herët për t'u lëshuar në vlerësime mbi mandatin e dytë, por e rëndësishme në këtë mes është se dinamika e punës nuk mungon dhe na presin ende shumë gjëra për t'i bërë bashkërisht, meqenëse jemi një ekip i konsoliduar, me përgjegjësi të ndara në dikasteret ku kemi vlerësuar secili prej nesh se mund të japim më të mirën tonë. Unë jam optimist që në fund do të flasë vetë puna kur të bëhet një bilanc i asaj që kemi bërë e që potencialisht ka mbetur pa bërë.

"Epoka e re": Sa po zbatohet programi i AKR-së dhe i juaji për kryeqytetin?

Pacoli: Bashkëpunimi me kryetarin Ahmeti është në nivelin e duhur dhe qeverisja po bëhet në bazë të parashikimit programor që shërbeu edhe si parakusht i arritjes së marrëveshjes përpara raundit të dytë të zgjedhjeve. Sa iu përket projekteve, disa prej tyre janë të derivuara nga planprogrami i AKR-së por tashmë, pas harmonizimit programor, gjërat po shtyhen përpara si një. E rëndësishme është që investimet kapitale në kryeqytet nuk do të mungojnë dhe rinia, si pika ime kryesore, nuk do të lihet anash, por do të jetë prioritet, bashkë me Prishtinën e gjelbër, investim i cili është i domosdoshëm.

indikator pozitiv është edhe krijimi i policisë së kryeqytetit që, me stafin e vet të dedikuar enkas për Prishtinën, do të jetë efikase për menaxhimin e sfidave, prej atyre në trafik e më gjerë, në bazë të kompetencave që i jepen. Me këtë ligj Prishtinës i garantohet edhe spitali. Një gjë tjetër që vlen për t'u përmendur është mundësia e krijimit të ndërmarreve publike nga komuna, duke mos iu nënshtruar procedurave me nivelin qendror që, nga përvoja, janë dëshmuar problematike në të kaluarën.

"Epoka e re": Kryeqyteti u bë me ligj 10 vjet pas shpalljes së pavarësisë. Pse mendoni se

Lëvizja Vetëvendosje (LV) prezanton propozimin "Plani 4+1" për dialogun me Serbinë

Kurti kërkon dialog me Serbinë pa përfshirjen e Thaçit dhe Tahirit

Në asnjë rrethanë presidenti Hashim Thaçi dhe ish-ministrja Edita Tahiri nuk duhet ta udhëheqin apo ta përfaqësojnë Kosovën në dialogun me Serbinë. Kështu ka thënë të hënën lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në një konferencë me gazetarë, në të cilën ka prezantuar propozimin e kësaj lëvizje "Plani 4+1" për procesin e dialogut

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MAJ - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të hënën se e vetmja formë për të pasur një përfundim të mirëfilltë të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është implementimi i propozimit të kësaj lëvizje "Plani 4+1". Kurti në një konferencë për medie ka theksuar se pika e parë e këtij plani kërkon të bëhet bilanci shtetëror i dialogut 2011-2017, të raportohet në Kuvend dhe të ketë debat parlamentar. "Para një dialogu të ri me Serbinë është e domosdoshme të bëhet bilanci shtetëror i dialogut 2011-2017: të raportohet në Kuvend dhe të kemi debat parlamentar. Ka pasur shumë investim, pak kthim dhe pak transparencë. 33 marrëveshje i kanë nënshkruar Kosova me Serbinë në dialogun gjashtëvjeçar. Shumica dërmuese e tyre nuk janë realizuar. Në veçanti duhet theksuar bllokimi që na e bën Serbia në fushën e energjisë elektrike, në urën mbi Ibër në Mitrovicë, në anë-

tarësimin në organizata ndërkombëtare dhe në reciprocitetin e njohjes së diplomave", ka deklaruar Kurti.

Ai ka kërkuar që për vazhdimin e dialogut me Serbinë të realizohet një dialog i brendshëm, si dhe një dialog me Bashkimin Evropian. "Të realizohet dialogu i brendshëm, i hapur e demokratik, në institucionet dhe shoqërinë tonë. Debate në Kuvend para dialogut e për dialogun me Serbinë, për parimet dhe agjendën, për qëllimet dhe formatin. Dialogu i brendshëm duhet të zhvillohet me kategori të ndryshme shoqërore dhe grupet e interesit, si dialog prej poshtë. Po ashtu, duhet të zhvillohet një dialog edhe me BE-në për dialogun me Serbinë, për natyrën, përmbajtjen dhe qëllimin e atij dialogu. Dialogu paraprak me BE-në është i nevojshëm edhe për vetë BE-në e cila ka shprehur interesim të ripërtërirë për integrimin e Ballkanit Perëndimor dhe ka filluar të mendojë për kalendarin përpara gjashtë shteteve të Ballkanit të cilat ende ngelen jashtë BE-së", është shprehur

Kurti.

Gjithashtu, Kurti ka thënë se duhet pajtim që të mos ketë asnjë shmangie në Kosovë nga prioritetizimi i punësimit dhe drejtësisë, si dhe nga dialogu me serbët e Kosovës dhe pakicat e tjera për zhvillim. Kurse pika e fundit për të cilën ka folur Kurti ka të bëjë me personat që do ta drejtojnë procesin e dialogut, duke thënë se në asnjë rast ata nuk duhet të jenë presidenti Hashim Thaçi apo ish-ministrja për dialog, Edita Tahiri. "Në asnjë moment, rrethanë apo rol kjo pajtueshmëri nuk mund t'i përfshijë emrat e Hashim Thaçit dhe Edita Tahirit. Nuk mund të udhëheqë më apo të përfaqësojë në këtë proces njeriu i cili në dialog me Serbinë nuk e ngriti çështjen e të pagjeturve, të dëmeve të luftës, të ndarjes së Mitrovicës e të shfrytëzimit të Trepçës, të shqiptarëve të shtypur në Preshevë, Medvegje e Bujanoc, të kontributeve pensionale dhe të depozitave bankare të vjedhura dhe të 172 pronave të Kosovës që janë nëpër ish-Jugosllavi", ka deklaruar Kurti.



KMDLNj-ja, Thaçi: Mos e dekretoni gjyqtarin Radomir Laban

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga presidenti Hashim Thaçi të mos e dekretojë Radomir Laban, i cili është zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. "Pasi deputetët e Kuvendit të Kosovës votuan dy kandidatët të komunitetit joshumicë, ndërsa refuzuan të gjithë kandidatët shqiptarë për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e që për KMDLNj-në paraqet 'non sens' të llojit të vet, u ngrenë dyshime për të

kaluarën e z. Laban i cili, sipas disa medieve të Serbisë, ka të kaluar kriminale dhe qenka dënuar për krim të organizuar. Për rastin në fjalë KMDLNj-ja mendon se është lëshim i atyre që është dashur ta bëjnë verifikimin e së kaluarës të çdo kandidati që ka konkurruar për pozitën e gjykatësit të Gjykatës Kushtetuese aq më parë që nuk mund t'u besohet kandidatëve për të kaluarën e tyre", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, nëse rasti Laban është përtej dyshimeve të

shprehura në media dhe dëshkohet e kaluara e tij, e cila është në s'përputhje me postin e synuar dhe, për fat të keq, të votuar nga deputetë të papërgjegjshëm, Llaban jo që nuk duhet të dekretohet si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, por ndaj tij duhet të fillojnë hetimet për paraqitje të pavërtetë të fakteve, fshehje të së vërtetës dhe falsifikim të dokumenteve. "Andaj, z. president Thaçi, KMDLNj-ja kërkon nga ju, si autoritet që vendos për dekretimin e



gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të mos e nënshkruani dekretimin e z. Laban derisa përfundimisht të mos sqarohet e

kaluara e tij, pas një verifikimi i cili doli të jetë i mangët për rastin konkret", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Projektkodi Penal i Kosovës u shkon për votim deputetëve

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MAJ - Në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, të kryesuar nga kryetarja e Komisionit, Albulena Haxhiu, është shqyrtuar të hënën në parim Projektkodi Penal i Republikës së Kosovës. I pranishëm në këtë mbledhje ishte edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i cili ka dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me Projektkodin Penal, duke theksuar se janë ndryshuar mbi njëqind (100) nene të këtij Projektkodi, ndërkaq ka sqaruar se 19 sosh janë ndryshime rreth çështjes së krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Kanë qenë tri parime themelore që na kanë diktuar punën për hartimin e këtyre ndryshimeve, si: përcaktimi i qartë për sundim të mirëfilltë të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, fleksibilitet më i madh në punën e organeve të pavarura të zbatimit të ligjit, si dhe mbrojtja,

promovimi dhe avancimi dhe nocioni i të drejtave të njeriut", është shprehur ministri Tahiri. Ai ka shtuar se ky kod është në harmoni të plotë me standardet e Bashkimit Evropian, duke shënuar kështu një avancim në reformën tonë, në sistemin e drejtësisë.

Tahiri shpreson në mbështetjen dhe konstruktivitetin e deputetëve të Kuvendit që të përkrahin këtë akt legjislativ, i cili, sipas ministrit, përveçse do t'i përmbushë kërkesat e Bashkimit Evropian për parandalimin dhe luftimin e dukurive negative si dhe nevojat e institucioneve të zbatimit të ligjit për parime të qarta dhe siguri juridike për qytetarët tanë, reflektohet drejtpërdrejt edhe në procesin e liberalizimit të vizave. "Ky projektkod i ri penal është një prej akteve legjislative më të rëndësishme të hartuara nga Ministria e Drejtësisë, i cili ka kaluar nëpër një proces jashtëzakonisht transparent, profesional dhe gjithëpërfshirës. Ky akt legjislativ paraqet draftin e konsoliduar dhe progresiv, që në njërin anë adreson zgjidhjen



e shumë problemeve konkrete me të cilat përballlet shoqëria jonë siç janë korrupsioni dhe krimi i organizuar, në anën tjetër shënon një progres të lartë në sistemin e drejtësisë", ka thënë

ai. Gjatë diskutimit të anëtarëve të Komisionit pati vërejtje për gabimet teknike, gjuhësore dhe të përkthimit në këtë Projektkod, ndërkaq u dhanë edhe disa

propozime të tjera. Pas përfundimit të diskutimit, Komisioni përkrahu në parim Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës dhe u procedua në seancë plenare.

Franca e Kosova do ta thellojnë bashkëpunimin në fushën e sigurisë

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, ka pritur të hënën në takim një delegacion të lartë të shtetit francez në krye me ambasadorin Didier Chabert. Me këtë rast, ministri Berisha ka falënderuar ambasadorin Chabert për mbështetjen dhe përkrahjen që shteti i Francës ka ofruar për Kosovën në shumë politikë, siguri etj., duke filluar që nga kontributi i Francës në kuadër të KFOR-it, kon-

tributi në administratë e në fusha të tjera. Ministri Berisha e ka njoftuar diplomatit francez mbi zhvillimet në sektorin e sigurisë në Kosovë, për integrimin e komunitetit joshumicë, si dhe për planet për të ardhmen. Ndërsa ambasadori i Francës në Kosovë, Didier Chabert, ka përgëzuar ministrin për të arriturat dhe për kultivimin e një bashkëpunimi të vazhdueshëm ndërmjet dy vendeve. Ambasadori e ka njoftuar ministrin Berisha

me emërimin e atashut të Mbrojtjes dhe akreditimin e tij për Kosovë, kolonel Fabrice Duda, si dhe ka paralajmëruar shtimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë. Ambasadori Chabert ka paralajmëruar vizitën zyrtare në MFSK të sekretares së shtetit pranë Ministrisë së Armatave në Oeverinë e Francës që do të zhvillohet së shpejti, vizitë kjo që pason vizitën e ministrit Berisha në Francë në vitin e kaluar.



Perceptimet e qytetarëve dhe përgjigja e komunitetit ndaj luftëtarëve të huaj të kthyer në Kosovë

Qytetarët u frikësohen të kthyerve nga zonat e konfliktit

Qytetarët e Kosovës vazhdojnë të besojnë se ekstremizmi i dhunshëm mbetet kërcënim serioz për sigurinë kombëtare. 75 për qind e të anketuarve që janë përgjigjur në raportin e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) mbi perceptimin e qytetarëve ndaj luftëtarëve të huaj të kthyer në Kosovë besojnë se ekstremizmi i dhunshëm paraqet kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës



EPOKA
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 21 MAJ - Raporti i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) mbi perceptimin e qytetarëve ndaj luftëtarëve të huaj të kthyer në Kosovë konstaton se besimi i qytetarëve në institucionet kryesore: Qeveri, Kuvend, gjykata dhe prokurori është shumë më i vogël sesa në Policinë e Kosovës, e cila për nga perceptimi i qytetarëve konsiderohet një nga institucionet më të besueshme.

Besim të qytetarëve nuk gëzon as Bashkësia Islame e Kosovës, institucion ky që ka pësuar rënie të besueshmërisë në krahasim me dy vjetet e kaluar. "25 për qind e të anketuarve konsiderojnë se ekstremizmi i dhunshëm me bazë fetare paraqet kërcënim. Rreth gjysma e të anketuarve e shohin ekstremizmin politik si kërcënim, në krahasim me 30 për qind që e shohin dhunën etnike si një kërcënim për sigurinë kombëtare", thuhet në raportin e QKSS-së.

Vetëm 34 për qind e të anketuarve janë të përkushtuar ndaj çështjes kombëtare, ndërsa 15 për qind e të anketuarve janë të përkushtuar ndaj çështjes fetare.

Të dhënat tregojnë se të anketuarit më të rinj i kultivojnë ndjenjat fetare më shumë sesa brezi i vjetër. Kjo gjetje është në përputhje me raportin e QKSS-së të vitit 2015. "52 për qind e të anketuarve më të rinj (nga 18-35

vjeç) preferojnë të angazhohen për një çështje fetare më shumë sesa për një çështje kombëtare, krahasuar me 72 për qind të të anketuarve më të vjetër (mbi 35 vjeç) që do të angazhoheshin për një çështje kombëtare", thuhet në raport.

Sa i përket rrezikut që qytetarët shohin nga të kthyerit nga zonat e konfliktit, raporti i QKSS-së konstaton se të anketuarit në zonat rurale mendojnë se ish-luftëtarët e kthyer paraqesin rrezik më të lartë në krahasim me të anketuarit në zonat urbane. "Të dhënat tregojnë se 62 për qind, ose shumica e të anketuarve, thonë se nuk do të praninin ish-luftëtarët të kthyer në lagjen ose komunitetin e tyre, ndërsa vetëm 25 për qind e të anketuarve deklarojnë se do t'i praninin të kthyerit me mbikëqyrje të vazhdueshme nga shteti", thuhet në raport.

Të dhënat tregojnë se rajonet si Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Ferizaj dhe Mitrovica e Veriut hezitojnë t'i pranoinë luftëtarët e kthyer në komunitetin e tyre.

Gjatë tre vjetëve të fundit ekstremizmi i dhunshëm ka dominuar në diskursin publik, me fokus të veçantë në kërcënimet dhe trajtimin e ish-luftëtarëve të huaj të kthyer nga zonat e kontrolluara më parë nga ISIS. Riintegrimi i luftëtarëve të kthyer dhe familjeve të tyre përbën sfidën kryesore për institucionet e Kosovës dhe për të gjitha

shtetet e tjera të cilat janë ballafaquar me këtë dukuri. Sipas të dhënave të institucioneve të sigurisë, deri më tani rreth 120 shtetas të Kosovës të cilët kanë marrë pjesë në luftën në Siri dhe Irak ose kanë jetuar në zonat e prekura, përfshirë 7 gra, janë kthyer në Kosovë.

Shumica e atyre që janë kthyer në Kosovë kanë kaluar nëpër sistemin e drejtësisë, disa prej tyre janë ndaluar, të tjerët janë ende në procedurat gjyqësore. Sidoqoftë, shumica e luftëtarëve të kthyer priten ta përfundojnë vuajtjen e dënimit me burg, të tjerët jetojnë në izolim dhe mbikëqyrje, disa priten të kthehen në muajt në vijim nga konflikti i Sirisë dhe Irakut. Shoqëria dhe institucionet e Kosovës po çalojnë në arritjen e

baraspeshës midis përgjegjësisë për të adresuar këtë sfidë dhe masave ndëshkuese që do ta ndihmonin Kosovën në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Ky raport ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë e raportit përbëhet nga një përshkrim i përgjithshëm i perceptimit të publikut mbi ekstremizmin e dhunshëm bazuar në të dhënat e grumbulluara në vitin 2017. Këto kategorizohen në kërcënime të motivuara në bazë etnike, ekstremizëm të dhunshëm me bazë fetare dhe ekstremizëm të dhunshëm të motivuar politikisht. Përveç kësaj, raporti analizon qëndrimin e të anketuarve ndaj çështjeve kombëtare dhe fetare. Pjesa e dytë dhe kryesore e raportit paraqet perceptimet e të anketuarve për ish-luftëtarët e

kthyer. Ajo vlerëson kërcënimin dhe rrezikun, si dhe gatishmërinë e komunitetit për t'i pranuar ata aty ku jetojnë dhe perceptimet e përgjithshme në lidhje me trajtimin e ish-luftëtarëve të kthyer. Gjetjet e këtij raporti kategorizohen në bazë të karakteristikave të mëposhtme të të anketuarve: zona e banimit (rurale/urbane), komuniteti ku jetojnë, gjinia dhe mosha.

Në fund, pjesa e tretë e raportit analizon besimin ndaj Qeverisë, Kuvendit, gjykatave, prokurorisë dhe Policisë së Kosovës, të gjithë hisedarëve kryesorë në zbatimin e Strategjisë së Kosovës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Raporti përmbledh trendet përgjatë viteve sa i përket besimit ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK).

Përkujtohen të rënë në Kaçanik



KAÇANIK, 21 MAJ - Në Stagovë të Kaçanikut është mbajtur të hënën manifestimi përkujtimor në nderim të 19-vjetorit të të rënëve për lirinë e Kosovës. Në këtë manifestim përkujtimor është kujtuar dëshmori Ekrem Gudaqi dhe 13 martirët e rënë më 21 maj të vitit 1999 në Stagovë: Hanife Jaha, Selvije Krivanjeve, Hanife Gudaqi, Ramush Jaha, Baki Bela, Ibush Rrushi, Ramadan Dashi, Fahri Mani, Bahrije Elezi, Sevdije Guri, Hamdi Dashi, Brahim Dashi dhe Fitim Gudaqi.

Po në këtë ditë është nderuar edhe dëshmori Kemajl Thaçi, i rënë në

Runjevë.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka thënë se të rënë për lirinë e Kosovës janë ata që kanë dhënë çdo gjë për Kosovën. "Kjo ngjarje ka hyrë në historinë e Kosovës dhe ne do të vazhdojmë t'i nderojmë ata që ranë për lirinë e Kosovës", ka thënë ai.

Edhe pjesëmarrësi në betejën e 21 majit të vitit 1999, luftëtari i UÇK-së, Rrahim Sadiku, ka thënë se në atë ditë, duke luftuar, mbrojtën civilët në këtë fshat. "Sot kujtojmë ata që ranë për lirinë e Kosovës, të cilët do t'i kemi përherë në mendjet tona", ka deklaruar Sadiku.

'Shell'-i filloi të veprojë me tetë pika të derivateve në Kosovë

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Tetë pikat e para të derivateve të kompanisë globale "Shell" në Kosovë janë tashmë të hapura për shitje. Pikat e reja të derivateve "Shell" janë të vendosura në Veternik 1, Veternik 3, Vragoli, Sllatinë, Obiliq, Mitrovicë, Prizren, Dragodan.

Në muajin janar "Al Petrol"-i u licencua si distributor i autorizuar i "Shell"-it pas nënshkrimit të kontratës me "Shell"-in. "Ardhja e 'Shell'-it është lajm i mirë për Kosovën", është thënë në njoftimin për medie të "AL Petrol"-it. "Kompania jonë ka më shumë se 50 pika derivate, të cilat deri në fund të vitit do të ribrendohen në 'Shell'. Po fillojmë me tetë pika të derivateve


'Shell'. Do ta vazhdojmë ribrendimin e të gjitha pikave. 'Shell'-i konfirmon hyrjen e vet në Kosovë përmes një kontrate licencimi të brendit të shitjeve me pakicë me 'Al Petrol'-in", është thënë në njoftimin për medie.

Më tej, në një njoftim të "AL Petrol"-it bëhet me dije se synim kanë që gjatë vitit të parë të aktivitetit të hapen më shumë se 50 pika të shitjeve me pakicë të brendit "Shell". "Hapja e pikave të reja 'Shell' në Kosovë është pjesë e një strategjie më të gjerë për përmbushje të aspiratave të 'Shell'-it për rritje dhe zgjerim të pranisë së pikave të brendit 'Shell' në një numër tregjesh të reja. Këto pika do t'u përmbahen

standardeve më të larta të shërbimit, cilësisë së produktit dhe vlerave të brendit 'Shell'", është thënë në njoftimin e "AL Petrol"-it.

Brendi global "Shell" vjen në Kosovë falë punës së madhe dhe angazhimit të palodhshëm të Latif Kryeziut, president i "Al Petrol"-it, kompania më e madhe e derivateve në Kosovë.

Rrjeti i brendit "Shell" do t'u ofrojë vozitësve në Kosovë derivate që përdoren nga skuadra "Ferrari" në Kampionatin Botëror të Formulës Një të 2018-s. "Shell" është shitësi më i madh me pakicë në botë që operon në më shumë se 80 vende, të cilat çdo ditë u shërbejnë më shumë se 30 milionë klientëve.



USAID-i, partner me Zyrën Kombëtare të Auditimit për zbulimin e mashtrimit

EPOKA E Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 21 MAJ - Drejtori i misionit të USAID-it në Kosovë, Xhejms Houp, dhe Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për forcimin e përpjekjeve të përbashkëta në luftimin e korrupsionit në prokurimin publik në Kosovë.

Ky memorandum përcakton parimet udhëheqëse të bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe USAID-it, përmes aktivitetit komuna transparente, efektive dhe llogaridhënëse (USAID TEAM) në Kosovë.

Me këtë rast Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, ka thënë se është shumë e rëndësishme ngritja e kapaciteteve për identifikimin dhe raportimin e dukurive negative siç janë mashtrimi dhe korrupsioni.

Ndërsa drejtori i misionit të USAID-it në Kosovë, Xhejms Houp, ka theksuar se USAID-i



është i përkushtuar ta ndihmojë Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Qeverinë e Kosovës për zbulimin dhe luftimin e

korupsionit në prokurimin publik, duke garantuar një cilësi më të mirë të shërbimeve për qytetarët.

Shumë shpesh në Kosovë, qytetarët, organizata të shoqërisë civile dhe sektori privat raportojnë se fondet publike keqorientohen,

duke rrezikuar cilësinë e shërbimeve publike, dëmtuar besimin e qytetarëve dhe dekurajuar investimet e huaja. Një sistem efektiv i prokurimit përfshinë mekanizma që kujdesen për fondet publike dhe që minimizojnë humbjen e të hyrave përmes kontrollit të mashtrimit, humbjes dhe abuzimit.

Adresimi i këtyre dobësive në sistem është shumë me rëndësi për Kosovën.

Aktiviteti i USAID-it për komuna transparente, efektive dhe llogaridhënëse në mënyrë të veçantë do ta mbështesë ZKA-në në përpjekjet e saj për t'i ndërtuar kapacitetet për zbulimin e mashtrimit dhe për t'i forcuar mekanizmat e tjerë për minimizimin e humbjes së të hyrave, duke siguruar kështu shërbime më të mira për qytetarët. Gjithashtu, përmirësimet në prokurimin publik rrisin kënaqshmërinë e qytetarëve me punën e Qeverisë dhe forcojnë besimin në mes të Qeverisë dhe qytetarëve.

Lekaj e Dema flasin për bashkëpunim

PRISHTINË, 21 MAJ (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, është takuar të hënën me rektorin e universitetit "Hasan Prishtina", Marjan Dema, me të cilin ka biseduar për mundësitë e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Universitetit "Hasan Prishtina", lidhur me krijimin e hapësirës për praktikë të studentëve të profileve të ndryshme në këtë

ministri.

Ministri Lekaj, duke e falënderuar rektorin Dema, ka shprehur gatishmërinë e Ministrisë së Infrastrukturës që të ofrojë kushte për praktikë për studentët të profileve të ndryshme në këtë ministri, gjithmonë duke u mbështetur në ligjet në fuqi dhe në mundësitë që i ka ministria. Rektori Dema gjatë këtij takimi e ka njoftuar ministrin Lekaj me

reformat që po ndodhin në universitetin "Hasan Prishtina" si dhe për sfidat me të cilat po përballë ky universitet.

Lekaj e Dema janë marrë vesh që bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe universitetit të vazhdojë edhe në të ardhmen, në mënyrë që të dy këto institucione të krijojnë kushte dhe infrastrukurë sa më të favorshme për studentët.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Haradinaj kërkon të jetësohet sa më parë Zona Ekonomike Amerikane



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka kërkuar angazhim dhe seriozitet nga anëtarët e kabinetit qeveritar për përgatitjen e shpalljes së Zonës së Lirë Ekonomike Amerikane. Ai ka vlerësuar se ky është një projekt me efekte afatgjata zhvillimore dhe me mesazh të mirë për të gjithë investitorët e huaj në Kosovë

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 MAJ - Kryeministri Ramush Haradinaj në mbledhjen e Qeverisë ka kërkuar të hënën angazhim dhe seriozitet nga anëtarët e kabinetit qeveritar që kanë obligime për përgatitjen e shpalljes së Zonës së Lirë Ekonomike Amerikane në mënyrë që kjo të përfundojë në kohën e caktuar.

Kryeministri ka vlerësuar se ky është një projekt me efekte afatgjata zhvillimore dhe me mesazh të mirë për të gjithë investitorët e huaj në Kosovë. Haradinaj ka ngritur edhe shqetësimet për bllokimin e rrugës Prishtinë - Hani i Elezit nga rrëshqitjet e dheut. Ai ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës informata për punët që janë duke u bërë dhe për gjetjen e zgjidhjeve afatgjata për

rrëshqitjet e dheut në këtë zonë. Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për asistencë teknike në procesin e integritimit evropian. Asistenca pritet të japë rezultate për krijimin e mekanizmit për trajnim dhe asistencë teknike për komunikimin në mënyrë efektive të temave kyçe të procesit të integritimit, si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta të Ministrisë së Integritimeve Evropiane dhe donatorëve. Kontributi financiar i Qeverisë së Luksemburgut do të jetë në shumën prej dy milionë eurosh, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës është obliguar të kontribuojë me 100 mijë euro për realizimin e këtyre projekteve. Ministria e Integritimit Evropian,

Dhurata Hoxha, ka thënë se kjo marrëveshje ka të bëjë me zbatimin e MSA-së. "Marrëveshja aktuale është nënshkruar më 7 mars dhe ka të bëjë me projektin e përbashkët zhvillimor dhe me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Ka për qëllim ta fuqizojë administratën dhe të temave që kanë të bëjnë me integritimin evropian. Kontributi i Luksemburgut është dy milionë euro, ndërsa kontributi i Kosovës është 100 mijë euro", ka thënë ministrja Hoxha. Në mbledhjen e kabinetit qeveritar është aprovuar edhe Projektligji për eficientë të energjisë. Ky projektligj përcakton kornizën ligjore të domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e eficientës së energjisë në Republikën e Kosovës. Projektligji rregullon aktivitetet që kanë për qëllim zvogëlimin e intensitetit energjetik në ekonominë shtetërore dhe që i kontribuojnë zvogëlimin të ndikimit negativ në mjedis. Me funksionalizimin e këtij projektligji, Kosova mund të fitojë fonde prej 10 milionë eurosh. Kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për plotësimin me dy anëtarë të Bordit të Drejtorëve të

Ndërmarrjes Publike "Ibër Lepenc". Anëtarët e rinj janë Ejup Visoka dhe Mehmet Ballazhi. Vendimi përfundimtar për shpronësimin për interes publik të pronave të paluajtshme që preken nga ndërtimi i rrugës regjionale Deçan-Kozhuj, në zonat kadastrale të Komunës së Deçanit, ka marrë miratimin e Qeverisë në këtë mbledhje. Edhe vendimi preliminar për shpronësim të pronave të ish-ndërmarrjes shoqërore "Sharrprodhimi" që preken nga ndërtimi i "Qendrës së komunitetit" dhe "Shtëpisë së kulturës" në fshatin Restelicë të Dragashit është miratuar nga Qeveria e Kosovës. Me vendimin e miratuar nga kabineti qeveritar do të bëhet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim të pronave të paluajtshme që preken nga ndërtimi i Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit në zonat kadastrale të Komunës së Kaçanikut. Miratimin e Qeverisë e ka marrë edhe raporti vjetor për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2017. Raporti pasqyron përmblidhjen e vlerësimeve të

kryera në subjektet e sektorit publik në Kosovë për vitin 2017 dhe rekomandimet për përmirësime dhe ndryshime në menaxhimin e financave publike. Raporti ka për qëllim informimin e Ministrisë së Financave, Qeverinë, Kuvendin dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në subjektet e sektorit publik në Republikën e Kosovës. Ky raport do të procedohet në Kuvendin e Kosovës. Kabineti qeveritar është informuar për zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2017-2021. Ky është raporti i katërt në këtë vit dhe mbulon periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2017. Të dhënat tregojnë, sipas raportit, se gjatë vitit 2017 është arritur një nivel i zbatimit të programit në masën prej 62.05 %, pasi që janë zbatuar plotësisht 600 nga 967 masa të planifikuara. Me vendimin e marrë në mbledhjen e kabinetit qeveritar është bërë emërimi i bordit të përkohshëm të drejtorëve të Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës. Ky bord është i përkohshëm dhe mandati i tij do të zgjasë gjashtë muaj.

50 anëtarë të Vetëvendosjes në Vushtrri i bashkohen Nismës

VUSHTRRI 21 MAJ (ER) - Degës së Nismës Socialdemokrate në Vushtrri i janë bashkuar mbi 50 anëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje. Në mesin e tyre është edhe Fidan Klinaku, aktivist i dalluar nga partia e Albin Kurtit. Me këtë rast, partia e Fatmir Limajt ka themeluar dy nëndegë të reja në fshatin Bukosh dhe Bivolak. Kryetari i Degës së Nismës në Vushtrri, Abdullah Vojvoda, u ka uruar mirëseardhje të adieruarve nga Vetëvendosja. Ai është zotuar se anëtarët e ri do ta kenë

hapësirën e nevojshme për ta dhënë kontributin e tyre. I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), njëherësh anëtar i Kryesisë së Nismës, Skender Reçica, i cili ka falënderuar anëtarët e Vetëvendosjes që kanë zgjedhur këtë parti për ta vazhduar aktivitetin politik. Ndërsa Fidan Klinaku ka thënë se kanë zgjedhur Nismën për shkak se po jep shembull se si qeveriset në nivel qendror dhe në atë lokal.



Asnjë rast i infektimit me ethe hemorragjike në Malishevë

MALISHEVË, 21 MAJ (ER) - Gjendja epidemiologjike me Ethet Hemorragjike Krime Kongo (EHKK) në territorin e Komunës së Malishevës është nën kontroll. Kështu është bërë me dije në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilën e ka drejtuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha. Në këtë mbledhje është theksuar se nuk është regjistruar asnjë rast i infektimit me virusin e EHKK. Po në mbled-

hjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve të Komunës së Malishevës është raportuar edhe për çështje të tjera që lidhen me punën dhe aktivitetet e qeverisë komunale. Drejtori komunal për Shëndetësi dhe ai për Mbrojtje dhe Shpëtim kanë bërë me dije se, pavarësisht prej rasteve të thumbimeve nga rriqrat, deri më tani, sikur në tre vjetët e kaluara, nuk ka raste të infektimit nga virusi i EHKK-së, ndër-

sa është duke vazhduar dezinfektimi i zonave që cilësohen endemike. Në mbledhje është raportuar edhe për projektet që janë duke vazhduar sipas planifikimeve, ndërsa është pohuar se është duke u bërë edhe mirëmbajtja e hapësirave publike. Gjithashtu, është potencuar se inspektorati komunal ka ndërprerë punimet në një rast të ndërtimit, pasi pronari nuk kishte respektuar parametrat e lejuar për ndërtim.

Përfaqësues të diasporës nga 26 vende të ndryshme vizituan Mitrovicën

MITROVICË, 21 MAJ (ER) - Përfaqësuesit e komunitetit të diasporës shqiptare nga 26 shtete të ndryshme kanë vizituar Komunën e Mitrovicës, me ç'rast janë pritur edhe nga nënkryetari i komunës, Faruk Mujka dhe Nehat Bahtiri, shef i kabinetit të kryetarit të komunës, Agim Bahtiri. Bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në shtete të ndryshme perëndimore kanë ardhur në Kosovë për të marrë pjesë në konferencën e parë "Diaspora flet" që është mbajtur në Prishtinë, nën organizim të OJQ "Germin", ndërsa që në "Ditën e Komunave", udhëhequr nga përfaqësuesja e OJQ "Germin", kanë vizituar



Mitrovicën, për të cilën ata kanë qenë më së shumti të interesuar. Nënkryetari i Komunës së

Mitrovicës, Faruk Mujka, ka thënë se mërgimtarët kanë dhënë kontribut të jashtëzakon-

shëm për Kosovën. Ai ka theksuar se sot Mitrovica është një ndër qytetet më të sigurta të

vendit. Sipas Mujkës, në këtë qytet ka rënë në mënyrë drastike krimi dhe dukuritë negative. "Është rregulluar mjaft mirë infrastruktura e brendshme e qytetit dhe në viset rurale, ndërsa që janë bërë hapa të mirë në krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik", ka thënë nënkryetari Mujka. Gjatë qëndrimit në Mitrovicë përfaqësuesit e diasporës shqiptare vizituan shëtitoren kryesore të qytetit, urën kryesore të Ibrit, fabrikën e kërpudhave në Gushafç dhe liqenin artificial në Suhadoll, për të cilin thanë se është një investim jashtëzakonisht i mirë dhe atraksion për vizitorët.

Komuna e Gjakovës formon komisionin për identifikimin e pronave komunale

GJAKOVË, 21 MAJ (ER) - Nën udhëheqjen e kryesuesit Anton Shala të hënën është mbajtur mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa për këtë vit. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës, Shkumbin Kastrati, ka raportuar mbi përgatitjen dhe mirëmbajtjen verore të rrugëve. Ai ka treguar se është nënshkruar kontrata me KMR "Çabrat" dhe se me kohë janë bërë të gjitha përgatitjet e duhura në sajë të kriterëve dhe speci-

fikave. Kastrati ka thënë se në bazë të ligjit ditë më parë kryetari i komunës, Ardian Gjini, ka marrë vendimin që e njëjta kompani "Çabrat" ta bëjë edhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra. Ndërkaq drejtoresha e Drejtorisë së Kadastrës dhe Pronës, Afërdita Lama, ka njoftuar anëtarët e KPF-së se, pas vendimit të kryetarit të komunës, Ardian Gjini, është formuar një komision i cili do ta bëjë identifikimin dhe menaxhimin e pronave

komunale në shtatëdhjetë zonat kadastrale të komunës. Kurse Durim Halilaj, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, ka dhënë raportin mbi menaxhimin e aseteve komunale (inventarit), duke bërë me dije se ky raport pasqyron të gjitha pasuritë komunale të regjistruara në sistem të kontabilitetit komunal, në saje të së cilës rezulton se vlera aktuale e pasurisë sipas drejtorive është në shumën prej 52 976 045.28 eurosh.



'REPUBLIKA QENDRORE E BALLKANIT'



Agim VINCA

Kontestit midis Greqisë dhe Maqedonisë për emrin e kësaj të fundit duket se po i vjen fundi. Shqiptarët, natyrisht, nuk mund të jenë indiferentë ndaj emrit të vendit në të cilin jetojnë (fjala është për shqiptarët në Maqedoni), ndonëse as shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës nuk do të duhej të jenë të painedesuar për emrin e shtetit në të cilin jeton një pjesë e konsiderueshme e bashkëkombësve të tyre. Propozimi i fundit nga pala maqedonase, i bërë nga kryeministri Zaev në samitin e

Sofjes: "Republika Ilindenase e Maqedonisë", të cilin dikush nga shqiptarët u kujtua ta përkthente si "Ilinditase" (?!), po refuzohet nga Greqia, por lidhur me të pati reagime, sado të vakëta, edhe nga shqiptarët, kryesisht nga disa intelektualë të paktë dhe ndonjë politikan.

Meqenëse pala greke, sipas lajmeve më të reja, nuk po e pranon këtë propozim, mbetet në opsion propozimi i mëparshëm, i bërë para tij: "Republika Gorna Makedonija", në gjuhën maqedonase, kurse në anglisht: "Upper Republic of Macedonia". Po në shqip? "Republika Maqedonia e Epërme". Megjithëse ky propozim ka pasur njëfarë përkrahjeje, aty-këtu edhe nga ndonjë analist me emër (V. Surroi), as ky emërtim nuk na duket i përshtatshëm, madje

jo vetëm nga prizmi shqiptar. Sepse, nëse paska "Maqedoni të Epërme", a do të thotë se ka edhe një Maqedoni "të poshtme" dhe "të mesme"? Së këndejmi, ky propozim hap dilema të panevojshme. Pastaj, banorët e shtetit me këtë emër si do që quheshin: "Gornomakedonci"? Në gjuhën shqipe një emërtim si ky është jo vetëm i papërkthyeshem, por edhe i pakuptimtë. Rrjedhimisht, emërtimi "Republika Gorna Makedonija", së paku për shqiptarët, është dhe do të duhej të jetë i papranueshem. Shumë më i mirë se këto dy propozime do të ishte ai i para disa viteve: "Republika e Maqedonisë (Shkupi)", të cilin me sa di e pati propozuar Athina zyrtare, kurse Shkupi zyrtar i atëhershëm, "radikal", e pati refuzuar me pretekstin se cenon identitetin historik të

vendit, sado që ky arsytim nuk qëndron aspak.

Nuk është dëgjuar deri më sot një propozim, për të cilin kam menduar kaheerë ta hedh në opinion dhe i cili do të ishte i pranueshem besoj për të gjitha palët: edhe për grekët, edhe për shqiptarët, edhe për ndërkombëtarët e, pse jo, edhe për vetë maqedonasit: "REPUBLIKA QENDRORE E BALLKANIT" ose "REPUBLIKA QENDRORE BALLKANIKE".

Ky emërtim reflekton pozitën gjeografike të shtetit dhe strukturën etnike të tij. Maqedonia shtrihet në qendër të Ballkanit, midis Shqipërisë, Greqisë, Serbisë, Bullgarisë dhe Kosovës, me të cilat kufizohet, kurse popullsia e saj përbëhet nga: maqedonasit sllavë dhe shqiptarët etnikë, që paraqesin dy bashkësitë kryesore etnike të vendit, por

ka edhe turq, vlllehë, romë, boshnjakë, serbë, grekë, bullgarë etj.

Emërtimi "REPUBLIKA QENDRORE E BALLKANIT" ose "REPUBLIKA QENDRORE BALLKANIKE" i sintetizon të gjitha karakteristikat gjeopolitike, etnike dhe, madje, edhe kulturo-historike të këtij vendi ballkanik, sikurse edhe rregullimin e tij shtetëror si republikë. Në Afrikë ekziston një shtet me emrin: "Republika Qendrore Afrikane", i cili më parë (deri në vitin 1976) është quajtur: "Mbretëria Qendrore Afrikane", prandaj emërtimi i një shteti evropian dhe ballkanik sipas këtij modeli nuk do të ishte precedent.

Përndryshe, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, e shpallur shtet i pavarur që nga viti 1991, do të vazhdojë udhëtimin e saj nëpër botë si FYROM, ashtu si po ndodh për gati tri dekada.

POLITIKA ËSHTË GJITHMONË EDHE 'LUFTË'



Nga Mimoza KELMENDI

Nuk është as rastësi dhe as fatkeqësi që partitë kryesore në Shqipëri apo Kosovë theksojnë përkrahësinë e tyre në demokracinë evropiane me vlerat e përbashkëta themelore, ndërsa ndryshimet dhe polemikën i përcaktojnë me interpretimin e ndryshëm të këtyre vlerave. Këto vlera themelore nuk mund të realizohen asnjëherë plotësisht dhe përfundimisht. Shoqëria pafundësisht e lirë, tejet e drejtë dhe solidare, nuk do të ekzistojë kurrë. Mbi atë çfarë i shërben

lirisë, çfarë është e drejtë dhe çfarë nxit solidaritetin, do të polemizohet gjithmonë. Drejtësia absolute nuk mund të ekzistojë, sepse njerëzit asnjëherë nuk do të jenë të një mendjeje se cila është ajo. Kësaj i shtohet edhe fakti që çfarë dikur konsiderohej si drejtësi, prej një brez më vonë cilësohej padrejtësi. Vlerat themelore u ngjajnë atyre çka Emanuel Kanti i ka quajtur "ide rregullatore". Ato drejtojnë mendimin dhe veprimin tonë, pa u fiksuar ndonjëherë përfundimisht apo pa realizuar. Por kjo nuk do të thotë se ato janë utopi. Ekzistojnë liria, drejtësia dhe solidariteti, megjithëse asnjëherë në masë të mjaftueshme, asnjëherë të pakontestueshme dhe asnjëherë përgjithmonë. Vlerat themelore nuk përbëjnë në vetvete koncepte, por kon-

ceptet mund të orientohen, të frymëzohen dhe të korigjohen me to. Tri vlerat themelore përshtaten si kritere vlerësimi për çdo koncept politik. Sot dëgjojmë shpesh, kryesisht nga gra e burra shumë simpatikë, se politika duhet të jetë edhe zbavitëse. Ata, sigurisht, kanë të drejtë. Politika do të ishte e padurueshme nëse nuk do të ekzistonte kënaqësia në diskutim, polemikë, bindje, vendimmarrje, në veprim e dhënie forme e, para së gjithash, në sukses. Megjithatë nuk është e dëmshme nëse herë pas here filozofet gjermanë si Shmidt, Veber, Poper etje, na rikujtojnë se politika nuk është biznes, përkundrazi ose të paktën edhe një çështje jete a vdekjeje. Pikërisht sepse bëhet fjalë se si jetojnë njerëzit dhe se si janë të vendosur të mos jetojnë pasi ndihen "qenësisht të mohuar",

pasi ka gjithmonë palë të interesuara që prodhojnë me cinizëm të tilla ndjenja, politika është një veprimtari e rrezikshme e madje "me kokë në trastë". Xhohn dhe Robert Kenedi, Aldo Moro, Indira Gandhi, Olaf Palme, Anvar Sadat, Jitzhak Rabin dhe shumë të tjerë janë dëshmia më e qartë. Dy të tretat e revolucionarëve komunistë që themeluan komitetin qendror në kohën e Leninit, nuk mundën t'u mbijetonin "spastrimeve" të Stalinit. Në parlamentet e Republikës Federale Gjermane u ulën, pas Luftës së Dytë Botërore, jo pak gra e burra që kishin mbijetuar nga kampet e përqendrimit apo burgimet ndëshkimore disavejeçare, ndryshe nga shokët e tyre që nuk mundën të mbijetonin. Për ta politika ishte një angazhim për të cilin ia vlente ta paguaje me jetën. Që sot gjithçka është ndryshe,

për këtë nuk duhet t'i vijë keq askujt. E megjithatë mbetet e vërtetë: kush merret me politikë, pasi mbron një ide apo ideal të caktuar, nuk fillon një karrierë të zakonshme. Kush nuk është në gjendje të durojë armiqësinë, shpifjet cinike, nuk është për politikë. Kush nuk është në gjendje t'u bëjë ballë disa vjet kërcënimeve me vdekje, nuk duhet të kërkojë poste të rëndësishme. Kush i konsideron të neveritshme dhe të papranueshme metodat e sotme të rafinuara për vrasjen, të paktën politike, të një individi, ai nuk duhet ta vërë veten në shënjestër të tyre. Edhe në politikë ajri bëhet gjithnjë e më i rrallë, sa më lart të ngjitesh. Kush nuk e duron dot këtë, nuk ka pse të ngjitet. Politika nuk është vetëm "luftë", por është gjithmonë edhe "luftë".

Komuna e Gjilanit, gati për finalizimin e tregut modern

GJILAN, 21 MAJ (BR) - Komuna e Gjilanit është në procedurat e fundit të hapjes së tregut mobil modern për komunitetin serb te kisha "Shën Nikolla". Kryetari i Komunës së Gjilanit,

Lutfi Haziri, së bashku me përfaqësues të UN Kosova, të cilët janë financues të këtij tregu, kanë parë nga afër standet moderne tashmë të vendosura aty, ndërsa tregu pritët të hapet zyrtarisht gjatë ditëve në

vijim. Haziri ka njoftuar se Komuna e Gjilanit është në procedurë të hapjes edhe të tregut mobil në tregjet në lagjen "Arbëria" dhe te "Bunari i Përleplnicës".



E jashtëzakonshme

25-vjeçares i nxirren 106 kapsula kokaine nga stomaku

Policia indiane ka nxjerrë me sukses 106 kapsula kokaine nga stomaku i një gruaje që po përpiqej t'i kontrabandonte. Policia beson se 25-vjeçarja i ka gëlltitur kapsulat në Sao Paulo në Brazil dhe më pas u ishën dhënë udhëzime për t'ia dorëzuar një shtetasi nigerian në Delhi. Shtetasja nga San



Paulo u arrestua në aeroportin ndërkombëtar, në kryeqytetin Delhi, më 14 maj.

FOTO E DITES




Anëtarët e Forcave të Armatosura ngasin kuajt gjatë paradës me rastin e ceremonisë së martesës së Princit Harry dhe Meghan Markle në Windsor të Anglisë. /AP/

E rrallë

Foshnja e parë në 12 vjet, në ishullin ku ndalohet të lindësh

Një ishull i largët brazilian në Atlantik, në të cilin është i ndaluar me ligj sjellja në jetë e fëmijëve, ka festuar për një ngjarje "historike", ardhjen në jetë të foshnjës së parë në 12 vjetet e fundit. Fernando de Noronha, ishulli që gjendet 370 km larg qytetit Natal, ka rreth 3 000 banorë,



por asnjë maternitet. Nënave që planifikojnë të sjellin në jetë një fëmijë u kërkohet të udhëtojnë në tokën kontinentale për t'i lindur foshnjat. Por, gruaje, e cila nuk dëshiron të identifikohet, solli në jetë një vajzë ditën e shtunë në këtë ishull.

BARSOLETA E DITËS



Te mjeku
- Doktor, më dhemb shumë mëlçia.
- A pini?
- Po, po... ama do të paguaj unë, s'ka llafe!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.


 <p>DASHI Harmonia në çift sot do të pasohet nga disa lajme mjaft të mira për jetën tuaj personale. Do të dini ta bëni dallimin midis njerëzve.</p>	 <p>DEMI Midis familjes dhe aktiviteteve personale do të zgjidhni të parën. Ndihehi mjaft mirë në ambientin tuaj të zakonshëm dhe nuk doni të largoheni.</p>	 <p>BINJAKËT Megjithëse dita e sotme është e mbushur plot aktivitete dhe e gjitha në lëvizje nuk do të lodheni aspak. Keni nevojë të eksplori gjëra të reja.</p>	 <p>GAFORRJA Blerjet dhe shëtitjet nëpër dyqane janë antistresi i ditës së sotme. Doni që në këtë atmosferë të këndshme të blini sa më shumë gjëra.</p>	 <p>LUANI Më mirë se kështu dita e sotme nuk mund të mbyllet. Përgjatë gjithë ditës keni menduar për momentet e mbrëmjes pranë partnerit.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Sot ndiheni mirë që shumicën e kohës do ta kaloni në ambientin e punës. Me këtë rast zgjidhni të gjitha ato ngërçe që nuk kishit mundësi më parë.</p>
 <p>PESHORJA Ju tërheq një person në ambientin e punës, por që nuk plotëson asnjë kusht nga ato që ju doni. Bëni mirë të largoni këto mendime nga koka.</p>	 <p>AKREPI Megjithëse familja nuk ju përkrah në një projekt të caktuar, ju jeni të vendosur ta çoni përpara edhe sikur të mos keni asnjë ndihmë.</p>	 <p>SHIGJETARI Jeta është e mbushur me situata të bukura dhe sot ju do t'ju rastisin disa të tilla. Do të dini të vlerësoni më mirë atë që ju ka rezervuar dita.</p>	 <p>BRICJAPI Jeni duke parë llogaritë tuaja sepse keni shpenzuar shumë kohët e fundit. Duhet të filloni të kurseni sepse keni një festë përpara.</p>	 <p>UJORI Këtë periudhë duhet të jeni me humor të mirë. Keni ulje dhe ngritje humori të njëpasnjëshëm. Duhet të jeni më afër familjes.</p>	 <p>PESHQIT Sot nuk doni të takoni shumë njerëz dhe kjo gjë ju ka bërë disi më të mbyllur se ditët e tjera. Keni filluar të mendoni për situata të kaluara.</p>

Një tregimtar i ri i shtohet letërsisë shqipe

PRISHTINË, 21 MAJ - "Telegrami dhe tregime të tjerë" është libri i parë i shkrimtarit të ri Albin Mehmeti i cili sapo ka dalë nga shtypi nga shtëpia botuese "Armagedoni".

Tregimet e këtij libri, sipas një shënimi të kritikës së re Arдона Bullatovci, edhe mund të lexohen sistematikisht, por edhe të shkëputur nga njëri-tjetri. Ajo që i lidh bashkë këta tregime është mjedisi, është shoqëria, e cila mund të jetë e Kosovës për shkak të toponimisë së vendit, por dhe mund të jetë e huaj për shkak të skenave të paraqitura, në të cilat personazhet janë shumë dramatikë, pasi vepronjë brutalisht: therin me qelq dhe me thika njerëz dhe po të njëjtit gjuajnë me revole të kalibrave të ndryshme edhe brenda objekteve, edhe jashtë tyre.

Sipas Bullatovcit, Mehmeti këtë libër me tregime e shkruan për shijen e lexuesit entuziast, po edhe të atij që ka lexuar literaturë nga stilistika, semiotika dhe pragmatika, që ka dije për strukturën e tregimeve dhe për gjuhën e prozës dhe që i di domethëniet e figurave prozaikë. Së këndejmi dhe sipas saj, në tregimet e Mehmetit nuk është vetëm dulce et utile e Horacit po, përtej kësaj, është aparatura e post-modernizmit, me shumë mjete të



vetat.

Me këta tregime dhe me këta personazhe Mehmeti nuk ka qëllim vetëm t'i denoncojë fenomenet e mbrapshta që ata bëjnë, por dhe t'ua bëjë me dije atyre që i bëjnë, se ato janë shumë të turpshme dhe se, po qe se i bëjnë, ose do të përfundojnë prapa grilave, të burgosen dhjetëra vjet nga gjykatat, ose të vriten nga ata që ligjin e respektojnë ilegalisht.

Në rrëfimet e shkëputura të Mehmetit vepronjë kriminelë të emërtuar, të paemërtuar që, për motive tradicionale dhe për arritje

të famës, vrasin të rinj dhe të reja, të vjetra dhe të vjetër. Por, prapa këtyre rrëfimeve qëndron autori, me idetë dhe gjuhën kritike, i cili, duke tallur të kaluarën dhe duke i bërë një inspektim rasteve, përpiket t'i ndalojë krimin, korrupsionin dhe degjenerimin. Në këto faqe lexuesi gjen ironi kudo, pastaj satirë dhe sarkazëm. Me figurën e ironisë Mehmeti godet paditurinë, nacionalizmin, neglizhencën në spitalë dhe në institucione të ndryshme të shtetit, pastaj egocentrizmin, antiheroizmin etj.

KATËR DITË PËR PAFUNDËSINË

(Dëshmorëve, martirëve të masakrës së Dubravës)

*Ishim bashkë dhe po bisedonim
Për dashurinë, jetën, për kaltërsinë
Kur krahët e vdekjes sipër na fluturonin
Si shkëndija drite për pafundësinë*

*Ti po më thoshe që, nesër, me të gdhirë
Do ta sodisje një lindje, me buzëqeshje
E mbaj mend, të kuptova atëbotë aq mirë
Ndonëse s'ta thashë, përveç me heshtje...*

*Sakaq një bisht zjarri, si në përrallë
Pas tij nuk vonoi dhe një i dytë
Po prisja si ti, edhe unë në radhë
Të më zbriste qielli vetë tek sytë*

*Dikush mund ta quajë të tërën: marrëzi!
Që prisja dhe në sytë e mi një qiell
Por, ti s'mendon kështu, e di
Teksa m'i ngroh ditët si diell*

*Ishim bashkë atëherë dhe bisedonim
Për dashurinë, jetën, për kaltërsinë
Sot kur qielli të ka vënë medaljonin
Mua ma farfurit si puhizë-Lirinë...*

*Nuk mundëm bashkë të fluturonim
Për në krahët e tu ndjek unë pafundësinë...*

Besim Zymeri
Ferizaj, 20 maj 2018

Psycho, një roman largpamës



Shkruan: Elvi SIDHERI

Kur nis ta lexosh romanin "Psycho" të shkrimtarit Ilir Muharremi, gjëja e parë që të bie në sy është thellësia në të cilën përnjëherë zhytet lexuesi porsa kapërdin faqen e parë të këtij libri. Do pranuar se termi "Psycho" qysh në titull ta ofron një sintezë të përmbajtjes së librit, duke shërbyer si udhëzues mjaft i mprehtë për vijimin e lexueshmërisë së këtij romani, dhe qëllimisht edhe titulli është lënë në versionin anglez, për të ushtruar një efekt më të fuqishëm mbi kërshërinë e lexuesve, një element ky tepër me vend për mbarëvajtjen e këtij romani.

Por, sakaq do të ishte diçka tejet e cektë që thelbi i këtij libri të përmbledhej veç në titullin e tij, sado magnetik të jetë ai.

Vetë romani përshkohet nga një gjuhë e thiktë, nga pasazhe të tëra që depërtojnë mes

amullisë së shoqërisë Kosovës, mes dekadave dhe dokeve e shprehive shqiptare, mes dritëhijeve ekzistenciale të naratorit, përmes një stili vegues dhe një qëndrimi sfidues ndaj shumë rregullive të letrave shqipe gjer në ditët tona.

E qysh këtu shfaqet vetë guximi i këtij libri. Te synimi i jetësuar më së mirë nga pena dhe mendja e autorit për të gjetur dhe shfrytëzuar çdo mënyrë e secilin shteg të imagjinatës së tij krijuese, për të rrëzuar murin e radhës të autocensurës letrare shqipe, përherë duke shtruar njëkohësisht një udhë të re që arrin ta përçojë lexuesin në kapitullin e mëtejshëm jo vetëm të këtij romani, por edhe të kurajës ngadhënjese të lirisë themeltare të mendjes së shkrimtarit.

Merita e autorit, mënjanë cilësisë dhe krijueshmërisë së vlerësueshme në shtjellimin e këtij romani atipik, qëndron jo vetëm në risinë e mirëpritur që i sjell lexuesit falë një romani të tillë, por edhe në zbrërthimin e kthjellët që ai i bën nuancave më të errëta të shoqërisë.


Është një lloj psikologjie letrare, e shpërfaqur me një gjuhë aspak të drunjte, por gjithaq edhe qëllimisht të çeliktë sa i

përket dukurive që autori përshkruan nëpër faqet e këtij libri.

Gjithçka vërtitet përreth tërë skajshmërive të së ashtuqajturës "përditshmëri normale", të shoqërisë tonë, që normale ka veç emrin dhe përçapjet për t'i mveshur ndonjë mbështjellje normaliteti mungesës së moralit, shturjes, insitinkteve shtazarake, lakmisë së shfrenuar, kurvërisë femërore e mashkullore, rrënimin të shpirtit njerëzor dhe djerrinës emocionale ku pluskon prej kohësh shoqëria jonë në këtë kënetë të helmatisur.

Dhe ky boksi i përshkruar me kaq vërtetësi të mirëfilltë në këtë roman, të jep përshtypjen sikur me grushtin e tij të hekurt mëton faqe pas faqeje të godasë e dërrmojë çdo normë falsiteti ku kridhet shoqëria jonë pashërueshëm.

Pija, seksi, shtytjet e pshore, joshjet dehëse, gotat e zbrazëta, lekët në dorë, karrierat e stisura nga favore të mugëta, shndërrohen në këtë libër deri në një kanibalizëm aspak metaforik apo retorik, që nuk është asgjë tjetër veç një impulsi kafshëror që e shtyn njeriun drejt ekstremit, pasi shoqëria ia ka shteruar forcat me pafy-



tyrësinë dhe ligësinë e saj. Prandaj ky libër do të zërë vendin e merituar në bibliotekën tuaj, bashkë me

ngarkesën e originalitetit që ia karakterizon çdo faqe, mendim e ngjarje. Lexim të këndshëm.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

HELSINKI - FC INTER

1

VAASA - KUPS

GG3+

OSTERS - GAIS

1

Klubet nisin aksion e përforcimeve

Klubet e Kosovës në futboll duket se janë pjekur dhe më nuk do t'i presin ditët e fundit të afatit kalimtar për t'i bërë përforcimet e nevojshme, pasi ato tashmë kanë filluar "gjuetinë" për t'i rrëmbyer lojtarët që planifikojnë t'i ndjekin synimet në këtë edicion



pur për t'i ruajtur lojtarët e saj cilësorë, sidomos sulmuesin Kastriot Rexha, i cili po "lakmohet" nga Feronikeli dhe Prishtina. Lojtarët cilësorë që mund t'i rrëmbejnë klubet elitare pa ndonjë problem janë ata që kanë luajtur për Besën e Pejës dhe që edi-

cionin e ardhshëm nuk do të pëlqejnë shumë të luajnë në Ligën e Parë. Fjala është për Florent Papuqin, Mërgim Rexhajn, Liridon Balajn dhe Florent Qorrajn. Talenti Balaj për gazetë ka konfirmuar se vështirë do të jetë të luajë për Besën edhe

për një edicion tjetër. "Ende nuk kam vendosur por, me gjasë, do të largohem", ka deklaruar ai.

Para ndeshjes së fundit në kampionat për të ardhmen foli edhe Armend Thaqi, por pa zbuluar të ardhmen e tij. Repreruesi i Kosovës pritet që karrierën të vazhdojë në futbollin e Shqipërisë, pasi duket se është momenti që ai të bëjë një hap para në karrierë. Ish-kampioni i Kosovës, Feronikeli, po synon që, përveç Rexhës, ta transferojë edhe sulmuesin nga Shqipëria, Artur Magani, derisa Llapi raportohet se tashmë ka arritur marrëveshje me Bledar Hajdinin e Trepçës '89. Ky është vetëm fillimi i afatit kalimtar, kurse ditët e ardhshme pritet të janë edhe më interesante dhe do të ketë transferime "bombastike" në futbollin e Kosovës.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 MAJ - Vetëm një ditë pasi përfundoi zyrtarisht edicioni i rregullt në Vala Superligën e Kosovës në futboll dhe ende pa përfunduar finalja e Kupës, klubet në Kosovë kanë filluar të lëvizin për transferimin e futbollistëve. Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) të hënën i ka njoftuar klubet në të gjitha rangjet garuese se afati kalimtar i futbollistëve do të fillojë më 18 qershor dhe do të

përmbillet më 17 gusht.

Kampionia e re e Kosovës, Drita, duket se do ta bëjë "sefte" me sulmuesin Mevlan Zeka, i cili e ka zyrtarizuar largimin nga Liria e Prizrenit. "Ishte kënaqësi të jem pjesë e Klubit të Futbollit FC Liria ku, pas shumë sfidave, ia dolëm mbanë", ka thënë Zeka, i cili ka falënderuar trajnerin Bledi Shkëmbi, drejtuesit e klubit, bashkëlojtarët dhe tifozët. Mirëpo, Drita, e cila do të marrë pjesë në garat e Ligës së Kampionëve, duhet të jetë syha-

Ministri Gashi uron Dritën për titullin kampion

"I uroj futbollistët, stafin drejtues dhe atë teknik të Klubit të Dritës, për suksesin e arritur në sezonin 2017/18 të elitës së futbollit në Kosovë, sukses që u kurorëzua me fitoren e titullit të kampionit. Gjithashtu, i uroj edhe tifozët e KF Dritës për këtë rezultat, sepse e meritojnë përkrahjen e pakursyer që ata kanë ofruar për klubin e tyre të zemrës. I falënderoj edhe uroj edhe përkrahësit e tjerë që në çfarëdo forme e kanë ndihmuar klubin", ka thënë ministri Gashi

PRISHTINË, 21 MAJ - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, e ka uruar Klubin e Futbollit "Drita" të Gjilanit për fitoren e titullit të kampionit në Superligën e Kosovës në futboll për sezonin 2017/18. "I uroj futbollistët, stafin drejtues dhe atë teknik të Klubit të Dritës, për suksesin e arritur në sezonin 2017/18 të elitës së futbollit në Kosovë, sukses që u kurorëzua me fitoren e titullit të kampionit. Gjithashtu, i uroj edhe tifozët e KF Dritës për këtë rezultat, sepse e meritojnë përkrahjen e pakursyer që ata kanë ofruar për klubin e tyre të zemrës. I falënderoj edhe uroj edhe përkrahësit e tjerë që në çfarëdo forme e kanë ndihmuar klubin", ka thënë ministri Gashi, i cili ka shtuar se sezoni i sivjetmë është vlerësuar si ndër më të mirët si për nga organizimi dhe nga cilësia e ofruar dhe për këtë ndihet i kënaqur



sepse Kosova përmban futbollistë cilësorë dhe ka afinitet për sportin më të popullarizuar në botë, futbollin. "MKRS-ja dhe unë si ministër mbesim të përkushtuar që ta bëjmë të pamundurën që infrastruktura sportive, qoftë ajo ligjore apo ajo fizike, të përmirësohet e të plotësohet, si një parakusht që të rritet cilësia edhe më tej në futboll në veçanti, në

sportin e Kosovës në përgjithësi", ka shtuar Gashi.

Tash, pas ndërkombëtarizimit të sportit të Kosovës, i cili është një ndër faktet më të fuqishme të shtetësisë sonë, ka vlerësuar ministri Gashi për MKRS-në, prioritet është avancimi i fushës së sportit në një nivel tjetër, atë të nxjerrjes së talentëve të rinj dhe prezantimit më të mirë ndërkombëtar.

Majlinda Kelmendi pajiset me pasaportë diplomatike

PRISHTINË, 21 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pajisur me pasaportë diplomatike xhudisten e artë, Majlinda Kelmendin, trajnerin Driton Kuka dhe kryetarin e Federatës së Xhudos, Agron Kuka. Thaçi ka thënë me këtë rast se Majlinda është ambasadorja më e çmuar e Kosovës në botë. "Në mënyrë solemne sot kam ndarë pasaportën diplomatike për xhudisten e artë, Majlinda Kelmendin, për trajnerin Driton Kuka dhe kryetarin e Federatës së Xhudos, Agron Kuka. Majlinda është ambasadorja më e çmuar e vendit tonë dhe personifikon suksesin e Republikës së Kosovës në botë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Kampionia e Kosovës ftohet sërish në Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 21 MAJ - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) e ka pranuar ftesën zyrtare nga drejtori i Basketball Champions League, Patrick Comminos, që skuadra kampione e Kosovës

(2017/2018) të marrë pjesë në raundin kualifikues të kësaj gare për edicionin 2018/19. Ekziston mundësia që edhe një klub tjetër nga vendi ynë të marrë ftesë për edicionin e ardhshëm të garave

kualifikuese të Basketball Champions League. Duhet theksuar se ky është viti i dytë radhazi që Kosova ftohet të marrë pjesë në Basketball Champions League, pasi që në edicionin e

kaluar ishte Sigal Prishtina kampione, e cila garoi në raundin kualifikues, por që nuk arriti të vazhdojë më tutje, më pas luajti edhe në FIBA Europe Cup. Po në këtë garë nuk arriti ta kalojë

raundin. Data e fundit për ta paraqitur skuadrën në garat e Basketball Champions League, së bashku me të gjitha dokumentet e tjera mbështetëse, është 22 qershor 2018.

U hodh shorti për ndeshjet e barazhit

PRISHTINË, 21 MAJ - Komisioni i Garave i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), në praninë e përfaqësuesve të klubit, ka tërhequr shortin për ekipet në cilësinë e vendësit në ndeshjet e barazhit, të cilat do të zhvillohen në stadiumin "Rexhep

Rexhepi" në Drenas, me çfarë përcaktohen edhe hollësitë e tjera të ndeshjeve, si ngjyra e fanellave dhe ndarja e tribunave për shikuesit. Të mërkurën nga ora 16:00 do të takohen Vushtrria - Flamurtari, që do të thotë se vushtrriasit

janë në cilësinë e vendësit dhe do ta kenë tribunën qendrore për tifozët, derisa në ndeshjen që luhet të enjten, Ferizaj do të jetë në cilësinë e vendësit përballë Vëllaznimit. Ndërkohë, në ndeshjet e barazhit për Ligën e Parë, të cilat zhvillohen

në Gjakovë, më 28 maj, Istogu do të luajë kundër Rahovecit, derisa Trepça do të luajë më 29 maj me fituesin e ndeshjes përcaktuese për vendin e dytë në Grupin B të Ligës së Dytë, Lepenci - Dardana, që luhet më 25 maj në Drenas.



Haradinaj: Sportistët janë ambasadorët më të mirë të Kosovës në botë

PRISHTINË, 21 MAJ - Organizimi në Kosovë i Kampionatit Botëror të Notit për Personat me Sindromën Down është një nga ngjarjet më të mira që ka ndodhur në fushën e sportit. Për herë të parë Kosova po bëhet nikoqire e notarëve nga e gjithë bota. Kështu ka deklaruar kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, pas takimit me presidentin e Komitetit Olimpik Botëror të Notit për Persona me Sindromë, Geoff Smedley, kryetarin e Klubit "Termopan", Lulzim Zhdrella, fituesin e medaljes së artë dhe të argjendtë në garat e notit Medina Surdull, garues dhe përfaqësues të tjerë nga sporti i notit. "Sportistët e Kosovës çdo ditë e më shumë po dëshmojnë se janë ambasadorët më të mirë të vendit në botë. Me arritjet e tyre në sporte të ndryshme, siç është rasti i Medinës, ata sollën në Kosovë medalje të arta, duke na bërë krenarë në arenën ndërkombëtare", ka thënë kryeministri Haradinaj, i cili ka falënderuar presidentin e DSISO, Smedley, për hapësirën që po ua jep notarëve të Kosovës në përfaqësimet ndërkombëtare. Kryeministri Haradinaj theksoi gatishmërinë e Qeverisë së Kosovës



për t'i ndihmuar sportistët në Kosovë, duke vlerësuar lart rolin dhe gatishmërinë e tyre për ta përfaqësuar Kosovën në sportet ndërkombëtare. "Medina dhe notarë të tjerë me sindromën Down na bëjnë krenarë me angazhimin e tyre dhe do ta kenë përkrahjen e pazezervë të Qeverisë", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Ndërkaq presidenti i Komitetit Olimpik Botëror të Notit për Persona me Sindromë, Geoff Smedley, falënderoi kryeministrin për pritje, duke shprehur gatish-

mërinë e tij që t'i mbështesë notarët kosovarë në garat ndërkombëtare. Për herë të parë, Kosova u bë nikoqire e garës ndërkombëtare të notit për personat me Sindromën Down. Të pranishëm në takim ishin edhe përfaqësues të tjerë të DSISO-s dhe të klubeve të notit nga Kosova. Në fund të takimit, kryeministri Haradinaj i dhuroi presidentit të Komitetit Olimpik Botëror të Notit për Persona me Sindromë Down, Geoff Smedley dhe Medina Surdullit, "Medaljen e Skënderbeut".

Shqiponja, kampione e Kosovës në hendboll

GJAKOVË, 21 MAJ - Shqiponja e Gjakovës ka fituar titullin e kampionit të Kosovës në hendboll për femra për edicionin 2017/18. Shqiponja titullin e siguroi në ndeshjen e fundit të edicionit në Vushtrri. Skuadra gjakovare e mposhti Vushtrrinë me 21:19 dhe kështu, falë bilancit më të mirë në ndeshjet e ndërsjella me Vushtrrinë, përfundoi e para në tabelë. Të dy skuadrat i kanë mbledhur nga 33 pikë në 20 ndeshje, por titullin i gëzohet Shqiponja. Ishte ky një përfundim dramatik i një edicioni interesant në kampionatin e Kosovës për hendbolliste. Rrallë ndodh që ndeshja e fundit ta përcaktojë kampionin. Palestra në Vushtrri ishte e mbushur me rreth 1 500 shikues. Ndeshja ishte cilësore dhe



interesante. Shqiponja ishte në epërsi të lehtë thujse gjatë tërë kohës. Pas pjesës së parë rezultati ishte 13:10 në të mirë të mysafireve. Në minutën e 55-të rezultati u barazua në 18:18 e më pas edhe në 19:19 në minutën e 57. Por më pas vendaset nuk shënuan, ndërsa gjakovaret

shënuan edhe dy herë për ta fituar ndeshjen dhe titullin e parë në histori të klubit. Fazlija e Malaj me nga pesë gola ishin më efikasat në Shqiponja. Te Vushtrria u dallua Shala me gjashtë gola dhe Rrahmani me pesë. "Për herë të parë Klubi i Hendbollit Shqiponja, pas 19 vjetëve të formimit, fiton titullin e kampionit të Kosovës në konkurrencë të femrave. Jam shumë e lumtur që kontribuova për këtë titull që e merituar me kuptimin e plotë të fjalës. Bindshëm kemi qenë më të mira që prej fillimit të kampionatit. Edhe në ndeshjen e fundit, që ishte si një finale, ishim në epërsi thujse gjatë tërë kohës dhe fituam me plot meritë", ka thënë hendbollistja e Shqiponjës, Shpresa Fazlija.

SHKURT

Januzaj në listën paraprake të Belgjikës, mungon Nainggolan

Futbollisti shqiptar Adnan Januzaj është përfshirë në listën prej 28 futbollistëve që mund ta përfaqësojnë Belgjikën në Kupën e Botës "Rusi 2018". Ftesa për Januzajn ka ardhur pasi ka treguar paraqitje të mira gjatë gjithë edicionit me Real Sociedadin. Ndërsa befasisia më e madhe është mungesa e yllit të Romës, Radja Nainggolan.

Mourinho e kërkon Alderweireldin

Reparti i mbrojtjes në skuadrën e Manchester Unitedit ka qenë pika më e dobët në këtë edicion, prandaj trajneri Jose Mourinho po synon transferime gjatë verës. "Mirror" raporton se lojtari i Tottenham Hotspurit, Toby Alderweireld, është në listën kryesore të Mourinhos. "Djajtë" do të shpenzojnë në total 250 milionë funte në verë.

Real ofron dy yje për Neymarin

Real Madridi është duke u përgatitur që të përfshijë Gareth Balen dhe Toni Kroosin në transferimin rekord, për ta sjellë Neymarin në kryeqytetin e Spanjës, raporton "Don Balon". Ofertat e Florentino Perezit janë refuzuar deri më tani nga Paris Saint-Germaini, pasi kampioni i Ligës 1 kërkon 400 milionë për 26 vjeçarin brazilian. Por, Perez do të tentojë të ulë atë çmim në 200 milionë duke ofruar edhe Balen dhe Kroosin.

Golden State kryeson në finale ndaj Houstonit

Golden State i kundërpërgjigjet Houstonit në finalen e Konferencës së Perëndimit, në kampionatin amerikan të basketbollit, NBA. Skuadra kampione në fuqi fitoi sfidën e tretë ndaj tek-sanëve në "Oracle Arena", me rezultatin 126-85, e tani kryeson serinë e përballjeve me të 2-1. Golden State zhvilloi ndeshjen e përkryer ndaj Houstonit, e këtë e tregon diferenca prej 41 pikësh në rezultatin përfundimtar të sfidës, që përbën edhe humbjen më të rëndë të pësuar nga Rocketsi.

Stephen Curry ishte i papërmbyshëm në këtë sfidë, të cilën e mbylli me 35 pikë, 18 nga të cilat i shënoi në periodën e tretë, ku pati një saktësi mbresëlënëse, pasi i shënoi të shtatë tentativat e tij në këtë 12-minutësh. Ekuilibri në parket mes skuadrave zgjati më pak se një periodë. Në fundin e pjesës së parë Golden State kishte krijuar një avantazh prej 11 pikësh, 54-43. Me fillimin e periodës së tretë filloi edhe spektakli i Curryt dhe Houstoni u dorëzua pa kushte. Në periodën e katërt Golden State regjistroi rezultatin e pjesshëm 38-18, duke bërë që të krijohet pikërisht diferenca prej 41 pikësh me tek-sanët, të cilët, ç'është më e keqja, shënuan 20 sulme të humbura. Stephen Curry nuk ishte i vetmi që shkëlqeu në parket. Përveç tij u dalluan edhe Kevin Duranti me 25 pikë, Klay Thompson me 13 dhe Igoudala me 10 pikë, ndërkohë që Draymond Green e mbylli sfidën me 17 pikë e 6 asistime. Në krahun tjetër James Harden nuk ishte në ditën e tij më të mirë, pasi në këtë ndeshje shënoi 13 pikë dhe dha 10 asistime.

Moncao "blindon" Jardim

Zëvendës-presidenti i Monacos, Vadim Vasilyev, "blindon" trajnerin Leonardo Jardim. Numri dy i klubit nga principata deklaroi se ëndrra e tij është që Jardim të bëhet si Ferguson dhe të qëndrojë për shumë kohë në krye të skuadrës. Ai theksoi se 43-vjeçari ndihet i lumtur dhe se ka një kontratë, kështu që do të qëndrojë në Monaco. Vasilyev foli edhe për suksesin në kampionat, ku ekipi u rendit në vendin e dytë me 80 pikë. Ai pohoi se kjo është një kënaqësi dhe arritje e madhe, pasi për të katërtin vit do të luajnë në Ligën e Kampionëve. Në fund Vasilyev falënderoi edhe një herë trajnerin për punën e madhe dhe tifozët për mbështetjen që i kanë dhënë skuadrës.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

Prishtinë, 21. 05. 2018

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Neni 25, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Neni 23, Këshilli Drejtues mori vendimin për shpalljen e konkursit për:

Drejtor

të Institutit të Historisë "Ali Hadri"

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim:

1. Të jetë doktor i shkencave të historisë, përkatësisht t'i plotësojë kushtet për t'u zgjedhur së paku në titullin bashkëpunëtor i lartë shkencor.
2. Të ketë përvojë dhe aftësi të dëshmuara në organizimin dhe udhëheqjen e punëve kërkimore-shkencore.

Kandidatët së bashku me kërkesë, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër,
- Çertifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Përmbledhjen e përvojës menaxheriale, dhe përvojës kërkimore-shkencore,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetim.

Zgjedhja e drejtorit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, dhe Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri". Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/ 512 - 303, prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, rr. "Muharrem Fejza", pa numër (Ndërtesa e Arkivit të Kosovës).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit.



Specific Procurement Notice

-Legal Consultant- RCQ-MFK/002 -Environmental & Social Performance (ESP) Consultant- RCQ-MFK/003

The Government of Kosovo has received grant funding of USD\$49,000,000.00 (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to support Kosovo through a Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for Contracts for Goods, Works and Services.

To support this project MFK is seeking one (1) full time Legal Consultant (Individual Consultant) and one (1) full time Environmental & Social Performance (ESP) Consultant (Individual Consultant) to support the project.

Applications submission deadline: 29 May 2018, 11: 00 am local time.

Interested eligible consultant may refer to the other relevant documents (RCQ/TOR) at: millenniumkosovo.org



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

Prishtinë, 21. 05. 2018

Na osnovu Zakona br. 04 / L-135 za Naučno-Istraživačkim Aktivnostima (Službeni list Republike Kosova, br. 11/02 maj 2013), član 25, Statut Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini, član 23, Upravni Savjet doneo je odluku o raspisivanju konkursa za:

Direktora

Instituta za Istoriju "Ali Hadri"

Kandidati moraju ispuniti sledeće uslove:

1. Da je doktor istorijskih nauka, odnosno da ispunji uslove za izbor najmanje u zvanju višeg naučnog saradnika.
2. Da ima iskustvo i veštine u organizovanju i sprovođenju istraživačkog rada.

Kandidati zajedno sa prijavom moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Kratku biografiju,
- Potvrdu o rođenju koja nije starija od šest meseci,
- Rezime iskustva u rukovodstvu i naučno-istraživačko iskustvo,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom.

Izbor direktora Instituta za Istoriju "Ali Hadri" vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04 / L-135 za Naučno-Istraživačku Delatnost i Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri".

Zajedno sa aplikacijom, dostavlja se kopja dokumenata o kvalifikaciji, iskustvo i druga dokumentacija, koja su potrebna za radno mesto za koje konkurišu. Zajedno sa aplikacijom, dostavlja se kopja dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvo i druga neophodna dokumentacija, koji zahteva radno mesto za koje konkuriše.

Za detaljne informacije možete kontaktirati ovaj broj. tel: 038/512 - 303, od 08:00 do 16:00. Kompletne aplikacije se dostavljaju na adresu: Institut za Istoriju, ul. "Muharrem Fejza", Priština, bb. (zgrada Arhiva Kosova).

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Raif Bushi shpall te pavlefshme diplomën ShLP "Xhevdet Doda" Prizren
- Elda Susuri shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren
- Alil Memaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V- SHF "Naim Frasheri" Vlashnje
- Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151
- Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Kërkohet kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastruktura - Ministarstvo za Infrastrukturu - Ministry of Infrastructure

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L. -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, bën:

Na osnovu člana 12. stav 4. Zakona Br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo, i Zakona Br. 04/L-077 o obligacionim odnosima, u cilju pružanja posebnih usluga, vrši:

Shpallje të Konkursit Publik

për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta
Raspisivanje Javnog konkursa
za Ugovor o posebnim uslugama

Emri i Institucionit:	Ministria e Infrastruktura Ministarstvo infrastrukture
Njësia Organizative:	Departamenti i Transportit Toksor Odeljenje za drumski transport
Titulli i punës:	Zyrtar/e i/c transportit për zhvillim politikave Službenik/ca transporta za razvoj politika
Numri i referencës:	01-01/2018/MI/DTT/MSHV
Niveli i pagës:	437.55
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit të zhvillimit të politikave dhe marrëdhënies ndërkombëtare Rukovodiocu Divizije za razvoj politika i medunarodnih odnosa
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV) Ugovor o posebnim uslugama – (UPU)
Kohëzgjatja e kontratës:	gjashtë (6) muaj Šest (6) meseci
Orari i punës:	I plotë Puno
Numri i ekzekutuesve:	1 (një) 1 (jedan)
Vendi:	Prishtinë Priština

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Analizimi i veprimeve rreth implementimit të politikave që rrjedhin nga dokumentet strategjike të MI-së përkatësisht DTT-së;
- Implementimi i programeve nga fusha e trajnimeve profesionale në fushën e transportit rrugorë të udhëtarëve dhe mallrave;
- Implementimin e politikave të përcaktuara nga MI-ja lidhur me Takografin digjital respektivisht obligimet që dalin nga AETR-ja (marrëveshja Evropiane për orët e ngasjes dhe pushimit);
- Identifikimin dhe analizimin e obligimeve që dalin nga Traktati i Transportit të nënshkruar nga shtetet e Evropës Juglindore;
- Analizimi dhe identifikimi i linjave nder-urbane të cilat do të subvencionohen si linja të domosdoshme për qytetarët

Obaveze i odgovernosti

- Analizirane aktivnosti o sprovođenju politika koje proizilaze iz strateških dokumenata MI-a, odnosno ODT-a;
- Sprovođenje programa iz oblasti stručnih obuka u oblast drumskog transporta putnika i robe;
- Sprovođenje politika određenih od strane MI-a u vezi sa digitalnim tahografom, odnosno obaveze koje proističu od strane AETR-a (Evropski sporazum o satima vožnje i odmora);
- Identifikacija i analiza obaveza koje proističu iz Ugovora o transportu koji su potpisali države Jugoistočne Evrope;
- Analiza i identifikacija međugradskih linija koje će biti subvencionisane kao neophodne linije za građane

Kualifikimet për këtë vend pune:

- Diplomë universitare: Fakulteti Ekonomik, Juridik apo Shkenca Politike

Kvalifikacije za ovo radno mesto:

- Univerzitetska diploma: Pravni fakultet, Ekonomski ili Politicke nauke

Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë diplomë universitare, apo Master (me master përparësi)
- Së paku një (1) vite përvojë pune;
- Njohuri profesionale specifike në fushën e transportit ; politikave të transportit dhe marrëdhënies ndërkombëtare.
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës
- Aftësia për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ
- Shkathtësi hulumtuese , analitike dhe të vlerësimit të informacionit

- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Të flet rrjedhshëm gjuhën profesionale angleze;
- Të mos ketë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të mos ketë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë monetar, financiar ose interes tjetër në ndonjë organizatë biznesore që është e angazhuar në sektorin e transportit dhe të jetë person me integritet të lartë moral dhe profesional.

Sposobnosti, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju:

- Univerzitetska diploma osnovnih ili master studija (master diploma ima prednost)
- Najmanje (1) godine radnog iskustva;
- Specifična stručna znanja u oblasti transporta, politika transporta i medunarodnih odnosa.
- Sposobnost rešavanja problema za tehnička ili proceduralna pitanja koja proističu iz procesa rada
- Sposobnost za organizaciju svog rada i za koordinaciju osoblja na administrativnom nivou
- Istraživačke, analitičke i ocenjivačke sposobnosti informacija
- Kompjuterske veštine u programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);
- Da tečno govori engleskim jezikom;
- Da nije bio osuđivan za neko krivično delo;
- Da nema direktan ili indirektan novčani, finansijski ili bilo koji drugi interes u nekoj poslovnoj organizaciji koja je angazovana u sektoru transporta i da bude osoba sa visokim moralnim i profesionalnim integritetom.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077.Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

